



FRYMA *E*
ABSOLUTIT

DIALOGE ME MOOJIN

**E DUKSHMJA DHE E
PADUKSHMJA JANE NJE**

Përktheu **Ledion Azemaj**

Ky botim elektronik u publikua në Shqip në vitin 2023 nga Ionweb

Përktheu **Ledion Azemaj**

ionweb

PREZANTIM

Fryma e Absolutit është një koleksion dialogësh midis Moojit dhe kërkuesve të sinqertë të së Vërtetës që u zhvilluan në dimrat e viteve të fundit në Arunachala, kodra e shenjtë pranë qytetit të Indisë Jugore të Tiruvannamalai.

Tema e çdo prej bisedave të Moojit, dhe ky libër po ashtu nuk bën nuk përjashtim, është Vetja jote. Si një prind me zemër të ngrohtë e të dashur, ai përdor fjalë si një copë sapuni për të fshirë bindjet dhe supozimet e rreme që na kanë mbajtur të burgosur në një botë të krijuar nga vetë ne. Përpara se të marrim fjalën e Moojit dhe të hetojmë atë që ne besojmë se dimë, ne as që mund ta kemi kuptuar që ne jemi krijuesit e vuajtjeve tona. Kjo nuk do të thotë se kërkimi i së Vërtetës ka ndonjë tjetër qëllim përveç njohjes së saj.

Mooji thekson në vijim: *“Ne ekzistojmë; secili prej nesh tashmë e di këtë si një fakt.”* Por ajo që është e re dhe e freskët është ftesa e tij që të ngremë këtë pyetje prekëse: Si çfarë ne ekzistojmë?

Dhe kur kjo pyetje të fillojë të na emocionojë, prirja jonë për të dëgjuar dhe besuar në mendje na mban ende të mendojmë se na takon ne të krijojmë dhe të arrijmë Vetën tonë.

Ajo se kush ne jemi në të Vërtetë nuk kërkon asgjë që të na zbulohet, përveç gatishmërisë sonë për të parë dhe për të vënë në dyshim sugjerimet e njohura të mendjes. Zbulimi është i menjëhershëm dhe nuk nevojitet asnjë njohuri paraprake e asnjë lloji. Në fakt, për shkak të njohurive të fituara dhe besimeve tona në to, kjo e Vërtetë e thjeshtë e ekzistencës sonë na shfaqet si e turbullt dhe e paaksesueshme.

Mooji dekurajon që ky libër të lexohet sikur ai të ishte vetëm një libër shkollor për studim. Ai nuk i beson të mësuarit si një mjet që ti të kuptosh të Vërtetën. Fokusi i fjalëve të tij të urtësisë që ti gjen të shtypura në këto faqe është tërësisht në ngjalljen në ty vendosmërinë për të kryer dhe ndjekur hetimin që sugjerohet. Prandaj, ky botim nuk është për tu lexuar nga kapitulli

në kapitull apo edhe në rend vijues. Shko në çdo kapitull që të tërheq dhe lexoje atë paragraf pas paragrafi. Mos respekto konventën që do të të bëjë të lexosh një kapitull të tërë menjëherë. Qëllimi kryesor është që ti të mendosh në zemrën tënde atë që po ndahet me ty, pa e kthyer asnjë prej tyre në detyrë shtëpie. Kjo qasje mbështetet nga shkurtësia e kapitujve që gjithashtu janë të pavarura dhe të rregulluara pa ndonjë renditje të veçantë.

Kështu, prezantimi i materialit nuk supozon ndonjë progres.

Kujto se këshilla e Moojit drejtohet drejt Vetëdijes. Pra, lëre në dorë të Vetëdijes për ta realizuar atë. Nëse pyetjet dhe udhëzimet e dhëna nuk përqafohen me gëzim në zemër, atëherë kjo është një shenjë e qartë se mëndja është e angazhuar. Kur kjo ndodh, nuk do të thotë se je duke dështuar. Mos prano asnjë sugjerim suksesi ose dështimi, të cilat të dyja nuk janë gjë tjetër veçse ide që lindin në dhe si mëndje. Siç do të Mooji thoshte, *"ti je ende këtu, pranishëm si Observues në papërfshirje dhe neutral i suksesit ose dështimit të dukshëm."*

Mos u dorëzo! Fillimisht, mund të duket sikur je në mes të një ndeshjeje të një mundje krahu. Por, përfundimisht vendosmëria jote për të qëndruar në rrugën e duhur do ta bëjë mëndjen të dorëzohet, dhe e Vërteta që gjithmonë ka qënë këtu me siguri do të zbulojë përsëri veten si ty. Si mundet që jo? Mesazhi kryesor i Moojit është se ti je dhe se gjithmonë ke qënë Vetja, edhe nëse ajo ende pret njohjen në ty!

Edhe pse thamë se nuk kërkohet njohuri paraprake, Mooji sigurisht që përdor koncepte për të të drejtuar tek Vetja përtej çdo koncepti. Kjo mund të të duket si një kontradiktë. Terma të tillë si Absoluti, Vetëdija, Ndërgjegjja, Ekzistenca, Vetja dhe e Vërteta përdoren shpesh për të të drejtuar në Shtëpi. Përvoja e redaktorëve ka qënë se asnjë nga këto fjalë nuk ka nevojë për ndonjë përkufizim për t'u kuptuar. Ekziston një kapacitet i gjallë tek ne që di të përdorë konceptet e Mooji-t. Vetëdija me kalimin e kohës do të plotësojë gjithnjë e më shumë kuptimin e vërtetë me anë të vetë-zbulimit tënd, edhe pse ne duhet të theksojmë edhe një herë se nuk është një parakusht që njohja e vetvetes të shfaqet në tërësinë e saj.

Këta tregues nuk janë korniza solide që përmbajnë të Vërtetën. E vërteta nuk ka strukturë dhe nuk mund të kufizohet nga asnjë koncept. Ajo është pa formë, përtej dhe në të njëjtën kohë para çdo kuptimi mendor. Fjalët që burojnë drejtpërdrejt nga ky Burim – nëpërmjet asaj që është çliruar nga egoja – kanë jetën dhe fuqinë e tyre. Ndodh një transmetim energjik i së Vërtetës dhe jo një kuptim mendor. Pra, mos dëgjo kuptimet e paramenduara që fjalët mbartin për ty, përkundrazi dëgjo se nga vijnë këto fjalë dhe nga ku po merren në ty, sepse këtu është ku ato po drejtojnë.

Po kështu, Mooji thekson vazhdimisht se ai po flet si Vetëdije e pastër për Vetëdijen e pastër. Kjo është e vërtetë edhe kur referencat bëhen në planin relativ të ekzistencës, si 'përpyekja' dhe 'përgjegjësia'. Vetëdija "Unë jam" është si një shufër rrëshqitëse ku në njërin skaj "Unë jam" është vetëdija e pastër, e paprekur, e papërlyer, e paidentifikuar me asnjë objekt të perceptuar në manifestim, dhe në skajin tjetër është e njëjta vetëdije e humbur në identifikimin e saj me projeksionet e veta – mëndja egoike (shih kapitullin 'Në gjumë ndërsa plotësisht zgjuar'). Në çdo pikë përgjatë këtij shiriti, "Unë Jam" mund të adresohet. Duke qënë substrati themelor jodualiste e manifestimit, gjithçka përmbahet në brëndësi dhe buron nga Ajo, prandaj ajo për të cilën flitet është gjithmonë vetë Vetëdija.

Një shënim nga redaktorët për variacionet në drejtshkrimin e koncepteve të caktuara: Kuptimi i një termi të caktuar është identik, pavarësisht nëse ai është i shkruar me shkronjë ose jo. Për dallim më të madh, ne e përshkruajmë me shkronjë të madhe një term kur ai tregon drejtpërdrejt kuptimin më të lartë të Natyrës sonë jodualiste ose Unicitetit të Qënies, ndërsa varianti i tij me shkronja të vogla i referohet përdorimit të tij konvencional. Megjithatë, ky diferencim nuk duhet të të largojë nga mesazhi kryesor. Asnjë dallim i tillë nuk përcillet kur Mooji flet, dhe ende korret i njëjti përfitim.

Tani të ftojme t'ia kushtosh vëmëndjen tënde të plotë Mooji-t dhe Vetes tënde!

ADVAITA – RRUGA PA SHTEG

Mjeshtri yt, Papaji, shpesh quhet një mjeshtër Advaita. Sri Ramana Maharshi, i cili ishte Guru i Papajit, vlerësohet nga shumë njerëz që kanë gjallëruar këtë filozofi të lashtë jodualiste në kohët moderne.

Mund të të pyes atëherë, çfarë është Advaita në përgjithësi?

Advaita ka të bëjë me Ty; për atë se kush ose çfarë ti je. Apeli madhështor i Advaitas është se ti nuk ke nevojë për ndonjë sfond fetar. Ti nuk ke nevojë të besosh në asgjë fare. Njerëz nga të gjitha prejardhjet vijnë në Advaita dhe janë të mirëpritur. Një dëshirë e madhe brënda zemrës për të njohur veten ose për të qënë të lirë nga vuajtjet duhet të jetë aty për këdo që të kuptojë të Vërtetën e asaj që kjo filozofi e lashtë dhe praktike drejton.

Advaita është e drejtpërdrejtë në kuptimin që ajo drejton drejt së Vërtetës menjëherë, që në momentin e parë. Së pari ajo tregon se ti je në plotësi siç ti je; atëherë ajo fillon të të udhëheqë jashtë vuajtjes.

Nuk ka një rrugë. Kjo është e Vërteta përfundimtare. Ndërsa ky mirëkuptim thellohet, një barrë madhështore shpaloset. Këtu ti nuk të thuhet se ti duhet të jesh e aftë për këtë udhëtim; se ti duhet të meditosh çdo ditë; të jesh në përkushtim apo të fortë. Gjithçka që kjo lloj këshille e mësipërme bën është të vendosë detyra para teje përpara se ti të fillosh kërkimin tënd. Mungesa e çdo praktike shpirtërore në Advaita është ndryshimi kryesor kur krahasohet me shumë rrugë të tjera që fillojnë me supozimin se ti je mëndja jote, se ti je e lidhur dhe se duhet të bësh diçka për t'u bërë e lirë. Advaita të tregon që në fillim se kush ti në të vërtetë je ka qënë gjithmonë e lirë. Ti je duke u drejtuar direkt drejt realitetit gjithnjë të përsosur dhe të pandryshueshëm të Qënies - Vetja jote esenciale. Së pari, zbulo të Vërtetën, pastaj bëj atë që të pëlqen zemra.

Ka shumë liri Advaita atëherë.

Nuk ka vetëm shumë liri, ka Liri totale. Pse? Sepse Advaita po të thotë se Liria nuk është diçka që ti mund të fitosh. Liria është ajo që ti je.

Pra, në atë Liri, si shikohen dhe trajtohen emocionet?

Emocionet janë vetëm shprehje e Qënies universale. Gjithçka, jo vetëm emocionet por çdo veprim, çdo mendim, çdo lëvizje; gjithçka përfshihet në këtë shprehje të mrekullueshme të Qënies. Advaita nuk fokusohet në interpretimin e ndonjë lëvizjeje të veçantë. Pak vëmëndje apo rëndësi i është kushtuar kësaj 'loje dallgësh'. Emocioneve u jepet hapësirë për t'u shprehur, për të shterur shprehjen e tyre dhe për të gjetur përsëri paqen brënda Qënies.

Prania dhe loja e emocioneve nuk janë një masë e vetëdijes së pastër që ti je. Ajo që është zgjuar tek e Vërteta, nuk identifikohet më me asnjë objekt, mendim, person apo emocion. Ato nuk pësojnë asnjë zhgënjim sepse janë të lira nga pritshmëritë. Ato janë një me rrjedhën natyrore të manifestimit, me vallëzimin natyral të energjisë kozmike siç shfaqet në këta trupa. Megjithëse kushtëzimi mund ende të shfaqet, atje nuk ka asnjë lidhje të brëndshme me këtë. Kështu, ato mbeten natyrshëm të lira. Pa u identifikuar me kujtesën personale, e gjithë zhurma e kondicionimit shpërbëhet. Vetë koncepti i kushtëzimit, i njohur si mendim i thjeshtë, gradualisht me kalimin e kohës zbehet.

Sfondi im është joga dhe meditimi. Të jesh në satsang dhe të lexosh për Advaitan më bën konfuz disi.

Kjo është e natyrshme. Mëndja është e hutuar, sepse mëndja gjithmonë përpiqet të arrijë, të kuptojë, të ketë ndjenjën- "Unë e di këtë", "Unë e kuptoj këtë", "Unë e di se ku po shkoj". Mëndja është më shumë në një, projektion linear progresiv. Pra, fillimisht, kur ajo goditet nga diçka kaq e thjeshtë si jo-dualiteti, ku ajo nuk ka ku të 'shkojë', asgjë për të 'kapur', mëndja e kushtëzuar do të kufuzohet shumë, shumë konfuzive vërtetë.

Pra, në fakt është mjaft e thjeshtë.

Është më e thjeshtë se e thjeshtë. E thjeshtë nënkupton se është diçka që ti duhet të bësh që nuk është e vështirë, por kjo ekziston edhe para se të mendohet ideja e thjeshtësisë. Përjetohet si e vështirë sepse ti nuk mund ta heqësh nga mëndja idenë se ti je e lidhur.

Koncepte të panumërta merren nga mendja dhe duke u kapur pas atyre të pavërtetave ne mbysim spontanitetin tonë, njohjen e Qënies sonë të qënësishme. Pra, është mendja ajo që thotë: 'Unë nuk e kuptoj!' E si mund ta kuptojë mendja thjeshtësinë totale kur natyra e saj është të kompleksojë atë që tashmë është e natyrshme?

Cfarë është vetë-hetimi?

Vetë-hetimi është pasqyra në të cilën e Përjetshmja fillon njeh veten. Duke parë me ndihmën e kësaj pasqyre, ti arrin të kuptosh menjëherë se kush ti në të vërtetë je; jo se kush trupi juaj yt është, jo se kush ti e mendon veten të jesh apo kush të tjerët thonë se ti je; jo, përmes këtij vështrimi zbulohet një perceptim i drejtpërdrejtë jo-dualist i Vetes.

Vetja nuk është një objekt; e si mund të gjejë ose të arrijë mendja atë që nuk është objekt? Nuk e kam fjalën vetëm për objektet fizike. Një mendim është po aq objekt perceptimi sa çdo gjë materiale, dhe po ashtu janë edhe ndjenjat, imazhet, kujtimet dhe ndjesitë. Me pak fjalë, të gjitha fenomenet janë objekte. Mendja është mësuar të interpretojë dhe masë dukuritë. Pra, si mund të zbulojë mendja atë që është e vetëdijshme për fenomenet, që është Vetja - Realiteti i vetëm?

Ti je në vetëdijshmëri për çdo gjë që shfaqet përpara teje në ekranin e Vetëdijes. Ku është bota pa ty? Ku dhe çfarë janë mendimet pa ty, perceptuesin e tyre? Ku janë përvojat pa ty, ajo që i percepton ato? Ti je rrënja dhe burimi i çdo përvoje. Nuk mund të ketë asnjë përvojë pa ty.

Më kanë thënë se Advaita Vedanta është mësimi më i lartë shpirtëror.

Në të vërtetë dhe sinqerisht, Advaita nuk është një mësim. Unë nuk do ta quaja atë mësim. Një mësimdhënie kërkon dikë që do të studiojë dhe mësojë. Advaita hyn direkt dhe pyet: "*Kush është ai që do të mësojë? A mund të mësosh të jesh vetja?*"

Më shumë njerëz, mendoj, po kërkojnë lirinë.

Për të qënë i sinqertë, unë dikur besoja të njëjtën gjë, por më pas pashë se shumica e njerëzve po kërkojnë vecse përmbushjen e parashikimeve të tyre. Se me të vërtetë ata janë brënda mendjes së tyre dhe mendja vetëm

pretendon se dëshiron lirinë. Në fakt mëndja nuk e do fare Lirinë. Është gjëja e fundit që ajo dëshiron sepse Liria e vret mëndjen e kushtëzuar. Por po, ka një tërheqje në rritje drejt zbulimit shpirtëror. Kjo është një gjë e mirë, edhe nëse fillimisht kjo fillon në një mënyrë rrethrotulluese. Ti je në varkë. Ti mund të largohesh nga një varkë dhe të hipësh në një hoverkraft dhe më pas në një anije, por është ende mirë - megjithëse ti nuk je në ujë, të paktën je mbi ujë. Por nuk më intereson gjithë entuziazmi për këtë ndryshim madhështor në Vetëdijen universale që po ndodh, sepse ka shumë keqkuptime se çfarë e vërteta aktualisht do të thotë dhe është. Për të Vërtetën ti duhet të lësh mënjane dhe të zhvishesh nga të gjitha projeksionet, kushtëzimet dhe konceptet e tua, dhe më pas kur zhveshesh plotësisht, dhe nuk merr më të tjera të reja, ti qëndron lakuriq.

A mund të ndihmojë Advaita për të bërë një botë më të mirë?

Kur ti je çliruar nga ndikimi hipnotik i koncepteve të tua, kushtëzimit të mëndjes dhe projeksioneve të kota, atëherë ti me të vërtetë je në disponim për Vetën. Nuk do të ketë më asnjë energji të brëndshme kufizuese ose ndonjë nevojë për të manipuluar të tjerët për të kënaqur parashikimet e tua. Në një farë mënyre, mjedisi yt ngrihet automatikisht nga prezenca jote. Ashtu si pemët na japin ne oksigjenin për të marrë frymë, për të cilën askush nuk i falënderon, qëniet njerëzore që janë zgjuar në të Vërtetën rrezatojnë paqe të thellë, bashkësi dhe dashuri pa bërë asnjë përpjekje të vetëdijshme për ta bërë këtë. Paqja është vetë natyra e tyre. Ekziston një shprehje që thotë: *"Nëse kam një bukë dhe të jap gjysmën, më ka mbetur gjysma, por nëse të jap të gjithë njohurinë dhe dashurinë time, akoma më ka mbetur e gjithë njohuria dhe dashuria ime"*. Dhe kjo është ajo që ndarja e së Vërtetës është. Ti nuk po ndan objekte, është një ndarje e Subjektit, dhe Subjekti nuk mund të ndahet. Ti je Ajo.

Pra, për t'iu përgjigjur pyetjes tënde, a mundet Advaita, që do të thotë të kuptuarit e vërtetë dhe eksperiencat e së Vërtetës, të ndihmojë botën? Sigurisht që mundet! Edhe me vetëm hetimin tënd për të Vërtetën, ti jo vetëm që po ndihmon veten, por edhe qëniet e tjera ndihmohen automatikisht. Kur mëndja të jetë e kthyer drejt Drejtësisë, drejt Paqes, njëkohësisht do të ketë

një hetim për të hequr urrejtjen, frikën dhe dëshirën, të cilat janë të gjitha forma të injorancës. Hetimi yt është i shenjtë sepse ti e kthen fytyrën drejt së Vërtetës dhe njerëzit tërhiqen nga kjo e Vërtetë, që në fakt është një tjetër emër për atë që ne jemi.

Një njeri i uritur
nuk është i 'interesuar' për ushqim,
as është një njeri i mbytur
'i interesuar' për ajrin.

Për një që ka mall për Çlirim
Vetë-njohja nuk është një interes.
Është jetike.

BOMBA ME SAHAT PO TROKET

Ajo që ti je është kaq e thjeshtë - madje më e thjeshtë se e thjeshtë. Konfirmoje këtë për veten tënde dhe dije thellë. Kjo do t'i japë fund të gjitha vuajtjeve dhe marrëzive. Ti mund ta bësh këtë! Unë e di këtë nga përvoja ime. Është zbulimi im që unë po ndaj me ty. Kjo është arsyeja pse unë nuk mund të të dërgoj ty në rrugën e gjatë për në shtëpi. Zbulimi i Vetes është i drejtpërdrejtë dhe i menjëhershëm, dhe kjo është ajo që po të drejtoj drejt. Mos humb kohë. Zbulo, cili është esenca e asaj që ti e quan vete? Kur e ul avullin e saj, çfarë je duke parë?

Kuptova se duke parë kështu, jo vetëm që ajo nuk kërkonte një disiplinë të pabesueshme, por më e rëndësishmja u zbulua se nuk ka distancë për të kaluar për të qënë dhe për të njohur Vetën.

Vetëm një nxitje duhet të jetë në brëndësinë tënde për ta zbuluar këtë. Ti as nuk je përgjegjës për këtë. Ajo është si një bombë me sahat që po troket. Kjo bombë me sahat nisët nga ekspozimi yt ndaj së Vërtetës që po ndahet me ty këtu. Jo të gjithë janë në gjëndje ose të gatshëm të shikojnë direkt se kush ata janë duke vënë në dyshim supozimet më të dashura: "Unë".

Sa paradoksale, që të zbulosh se kush je duket kaq e vështirë. Mëndja mund të shpikë një marifet kaq të pabesueshëm - iluzion të pabesueshëm, mashtrim të pabesueshëm. E si tjetër mund ta shpjegojë dikush se pse Ajo që është më e dukshme është kaq qartë e humbur?

MASTËR ÇELËSI

Thjesht ndiej se duhet të ketë dicka më të thellë që është e pavarur nga të gjitha gjëndjet shpirtërore dhe nga gjithcka që ndodh!

Ekziston një kënaqësi që nuk ndikohet aspak nga loja sipërfaqësore në mëndje, emocionet apo ndonjë ndjesi, sado e dëndur apo delikate ato qofshin. Kjo kënaqësi nuk ka të bëjë me diçka, dhe kështu është e pamundur që ndonjë gjë të ketë ndonjë pushtet mbi të. Ajo është vetë-përmbajtëse, vetë-rrezatuese, e vetë-plotësuar. E zhytur në lumturinë e ekzistencës së saj, ajo nuk arrin për një "tjetër" që të përmbushë vetveten.

Nga kjo Kënaqësi del dhe luan i gjithë universi. Pjesë e kësaj loje është pakënaqësia që ti ndjen me cilësinë kalimtare të kënaqësisë së bazuar në ego, luhatjet e vazhdueshme të ngritjes dhe uljes emocionale, kjo sferë e paqëndrueshme e të kundërtave të ndërlidhura si edhe vetë fenomeneve.

Të gjithë kanë përjetuar paqe në një kohë ose një tjetër, por ajo nuk qëndron. Ndërsa dikush identifikohet si një entitet që i nënshtrohet këtyre gjëndjeve kalimtare, ekziston një preferencë e dukshme për gjëndjet që përjetojnë si psh; paqe dhe lumturi, dhe nga ana tjetër shmangien e atyre që nuk janë aq të këndshme, e sheh?

Ne kemi vënë kaq shumë energji për të mbajtur rrotullimin e rrotës së të menduarit pozitiv, të përparimit të vetvetes, të vetëkuptimit, të vetë-përmirësimit, duke besuar se disi me gjithë këtë përpjekje mund të arrijmë dhe të përjetësojmë një sferë të qëndrueshme gëzimi. Duhet një sasi madhështore burimesh së mëndjes dhe trupit për ta mbajtur atë vrull. Dhe nëse ti pushon edhe vetëm për një kohë të shkurtër, atëherë ajo fillon të bjerë, dhe ti detyrohesh ta marrësh përsëri atë dhe ta rrotullosh përsëri përpara. Rreth e rrotull ajo shkon. Me vizionin tend të vendosur vazhdimisht në një pikë imagjinare në të ardhmen, ose një ideal në mëndje se ku ajo do të përfundojë; të dyja janë të pamundura për t'u arritur.

Ky, i cili pedalon timonin, që praktikohet dhe përmirësohet, herë është entuziast, herë jo, herë shumë i lumtur dhe pozitiv për jetën, herë ndihet i dëshpëruar, madje edhe vetëvrasës; këtë do të doja që ta takoja. Atë që dëshiron një nivel më të thellë kënaqësie, kërkuesin e lumturisë së paprekur nga pikëllimi, le ta takojmë këtë, sot! Atë që thotë: *"Megjithëse kaq shumë vite praktikë, unë ende nuk e kam arritur atë gjëndje ekuilibri pa mundim."* A mund ta gresh këtë një që e thotë këtë?

Kjo pyetje është çelësi kryesor!

Unë besoj se ka fuqi në shpellën e Ramanës...

Ka fuqi në vetë shpellën tënde.

Ti duhet të ulesh brënda shpellës së Zemrës tënde.

Ramana është gjithashtu atje.

KUR VETVETJA SHIHET

Sri Ramana Maharshi thotë se kur një qëndron në Vete, Vetja shihet, dhe bota nuk shihet. Kur bota shihet, Vetja nuk shihet. Unë padysim që e shoh botën, kështu që sim und të këmbëngulësh ti, pra, që Vetja është gjithmonë këtu?

Kjo është një pyetje e bukur dhe e shkëlqyer, sepse për sa kohë që kjo do të mbetet e pazgjidhur për ty, njëfarë frike do të fshihet në sfond për të të ngacmuar me dyshime si këto: *'Kush po dëshiron të jetë Vetja, edhe nëse ajo është e bukur, nëse ka nuk ka një botë?'*, ose *'Nëse e kuptoj plotësisht Vetën time, familja ime nuk do të ekzistojë më. A dua unë ta marr këtë rrezik?'*

Për të trajtuar këto pyetje, le të fillojmë si në vijim. Për të perceptuar botën, duhet të ketë një perceptues të interesuar. Ti mund të besosh se ne të gjithë shohim të njëjtën botë, por kjo nuk është e vërtetë. Në fakt, secili prej nesh percepton një botë që është një e një lloji. Në çdo mekanizëm trup-mëndje, një ëndërr unike po ndodh. Çfarë dua të them me ëndërr? Dua të them se ti nuk po e sheh botën ashtu siç ajo me të vërtetë është, ti e sheh botën ashtu siç kushtëzimi yt të lejon ty që ta perceptosh atë. Më lejo të jap një shëmbull të thjeshtë nga jeta e zakonshme. Nëse ti ke një Volkswagen Beetle dhe ty të pëlqen kjo makinë, atëherë, nëse një tjetër e tillë është në qytet, ti do ta vëresh atë menjëherë. Ajo do të jetë fluoreshente për ty. Ajo vjen në vetëdijen tënde për shkak të interesit tënd. Përpara se ky interes të zhvillohej për ty, ti as që nuk i kushtoj fare vëmendje kësaj lloji makine. Ti nuk do ta kishe parë atë makinë edhe nëse ajo do të të kishte kaluar një milion herë përpara teje. Jam i sigurt që ti tashmë e di këtë. Kjo ilustron tendencën tënde për të parë atë që ti dëshiron të shohësh. Ti shikon atje ku kushtëzimi dhe vëmendja jote të drejton drejt.

Kur investigon atë që është e interesuar për një jetë në botë dhe zbulon se ajo është po aq fenomen i perceptuar sa edhe vetë 'bota', disi përmes këtij zbulimi Vetja zbulohet. Ku janë lidhjet e tua në atë moment njohjeje? Ku janë dëshirat e tua? Ku janë frikërat e tua? Ku është interesi yt vetjak? Gjithçka është hedhur në erë.

Shqisat janë ende duke funksionuar, imazhet e botës janë ende atje; por lidhjet dhe frikërat janë zhdukur, sepse ai që i përjetonte ato u zhduk. Ti je tani në Vete. Kjo është ajo Bhagavan shpreh kur ai thotë: "*Kur ti je Vetja, bota nuk shihet*".

Ramana është poashtu i njohur për këtë thënie të mrekullueshme:

Vetja vetëm është reale
Bota nuk është reale
Vetja është bota

Kjo e rrumbullakos bukur, sepse këtu Sri Ramana konfirmon se manifestimi material, që në vetvete është i pafajshëm, nuk zhduket; vetëm ai që ka krijuar një marrëdhënie personale me atë që shihet, zhduket. Kur kjo ndodh, bota shihet ashtu siç ajo është.

Ka një thënie që thotë;

Unë nuk po e shoh botën ashtu siç ajo është
Unë po e shoh botën ashtu siç unë jam

Kjo do të thotë se bota siç ti e sheh atë pasqyron atë që ti e mendon veten se je. Për sa kohë që ti e *blen* (merr) kondicionimin tënd si diçka që ka të bëjë me ty, ti po ëndërron një ëndërr ndarjeje në të cilën po e përjeton veten si një lojtar autonom në një botë që ti e do dhe nuk dëshiron që ta lëshosh. Kur zbulohet se të dyja bashkë, si kushtëzimi poashtu edhe ai që duket se është kushtëzuar janë vetëm ide që lindin në Qënien e pakushtëzuar - Veten - kjo ëndërr përfundon, me Heshtjen, Bukurinë dhe Paqen që i zbulohen vetes. Kjo është përvoja jote e menjëhershme. Kjo është përvoja jote e drejtpërdrejtë. Kjo nuk merr kohë!

Gjëja kryesore është
që të jesh në qartësi se çfarë ti je,
duke qënë në qartësi për atë që ti nuk je.
Kur kjo derë njohjeje hapet,
Hiri hyn.

TI JE PERFECT SIÇ TI JE

Unë përjetova një përvojë të rënies në zemër dhe mendja u ndal. A është kjo ajo se çfarë ti do të thuash me "të qëniet në heshtje"?

Ajo është të jesh në heshtje deri në atë pikë sa ti nuk e di më se kush është ai që është duke qënë në heshtje! Atje mbetet vetëm heshtja, jo një "ti" duke qënë në heshtje. Kur të mbetet vetëm heshtja, "Unë jam në heshtje" nuk do të jetë atje. Gjithçka shfaqet në Heshtje.

Mëndja ka shumë probleme me këtë lloj eksplorimi, këtë lloj zbulimi, sepse ajo nuk mund të krenohet me të. Ti po kthehesh në shtëpi në Natyrën-Buda, në vetëdijen e Vetëdijes-Krisht - në Heshtje të plotë. Kjo Heshtje nuk mund të fitohet dhe nuk mund të kapet, sepse nuk ka asgjë përveç saj për ta arritur atë. Ti je Ajo!

Ndonjëherë duket sikur 'unë' i vogël është nën sulm.

Mendimi që ti mban për veten tënde është nën sulm nga mendime të tjera; të gjitha këto të krijuara nga mendja jote. Në atë heshtje, mendja nuk mund të bëjë asgjë për ose rreth, sepse Ajo nuk mund t'i shtohet e as t'i hiqet asaj. Përtej mundësisë dhe konceptit të sulmit, heshtja nuk ka nevojë të mbrohet apo të mbrohet kundrejt. Ajo është perfekte ashtu siç ajo është. Ti je perfekt siç ti je. Vetëm kur të kesh pastruar veten nga gjithçka që nuk është ti, atëherë ti do të humbasësh frikën e Ekzistencës; atëherë ti do të kërcesh si vetë Ekzistenca.

Ja ku është imazhi i Atlasit, kjo figurë e struktur me botën mbi shpinë. Një tjetër figurë po kërcen në krye të botës, *Nataraj!* Dy anët e një shprehjeje. Ti ose mund ta mbash botën të rënduar mbi kokë ose të kërcesh.

Ti je *Nataraj*, ose Atlasi. Zgjedhja është e jotja.

Këtu ka disa prej jush që janë për herë të fundit. Ju nuk jeni të përkushtuar ndaj lirisë me këste; ju po shkoni për të gjithë gjënë. Një gatishmëri është e pranishme, thjesht për të zbuluar me gjithë qënien tuaj atë që mendja juaj po përpiqet të shmangë. Ju nuk po krijoni një mënyrë të të qëniet. Ju jeni ajo që

jeni dhe jeni ajo tani! Por, duhet të kujdeseni për mendimin që iu jep ndjenjën se ju keni ende diçka për të bërë, diku për të shkuar. Për shkak se ju i pranoni këto lloj mendimesh pa diskutim, përvoja juaj do të jetë ajo e të qenit të ndarë. Më pas atje ndodh një pritje delikate, por për çfarë? A do të vijë realiteti nga ndonjë vënd? Ndjenja e pritjes po e zgjat iluzionin e ndarjes.

Ndalo së krijuari apo mbajtur një imazh për veten, një imazh tëndin që nuk është ti. Kjo është një ide delikate, por e fortë në mendje. Jo të gjithë mund t'i dëgjojnë këto fjalë tani apo edhe të shohin se ku ato po drejtojnë në.

Të gjitha ato po drejtojnë te ty! Nuk ka asgjë që ti duhet të bësh për të Qënë.

TI DUHET TA SHIJOSH KËTË

Atje duhet të ketë ndonjë dëshirë për ty që zgjodhe vetë-hetimin dhe ta kryesh atë. Unë po të pyes, pse dëshiron të dish diçka mbi të gjithash?

Sepse ka ende një gjurmë te 'unë', dhe të jetosh si një 'unë' shkakton pakënaqësi.

A e zbulove vetë këtë apo e mësove?

Kjo është ajo që unë ndiej.

Mirë, kështu ajo se çfarë ti ndjen është se përderisa 'unë' është atje, ka pakënaqësi. Për kë është pakënaqësia?

Është vetë 'unë' që përfaqëson pakënaqësinë, është një kufizim.

Çfarë po e bën këtë observim se vetë "unë" përfaqëson pakënaqësi? Këto janë fjalët e tua. Më thuaj për kë është kjo e pakënaqshme? Tani po flasim fakte.

Pra, ti po thua, vërehet se kudo që ka një 'unë', ekziston pakënaqësia.

Çfarë po ankohet? Është kjo "unë" apo diçka tjetër?

Duhet të jetë 'unë'.

Duhet të jetë "unë". Nëse ky 'unë' është i pakënaqur, kujt do t'i ankohet ky 'unë'? Tani, ajo që e shikon këtë 'unë' të pakënaqur, a është ajo vetë e pakënaqur? Nëse ka kënaqësi apo pakënaqësi, për kë janë këto dhe çfarë i vëren këto?

Në shikimin tim, të zbulosh se kujt të gjitha këto përvoja i raportojnë është diçka që duhet të jesh në qartësi. Përndryshe, ti do të vendosësh shumë para dhe energji pas pyetjeve më të vogla, duke mos kuptuar se gjithçka që ti po bën është se po shter burimet e tua të çmuara në një kanal. Pra, shiko se në çfarë ti po investon dhe shiko nëse ia vlen.

Kur ti pyet se kush e di që ky 'unë' është i pakënaqur, menjëherë përgjigja vjen: Unë jam. Me këtë pyetje vëmëndja ime zhvendoset në këtë hapsirë vetëdije dhe atje gjithcka është në rregull.

Ngadalëso pak tani! Çfarë shikon madje edhe vetë Vetëdijen? A po shkoj shumë larg duke të të bërë këtë pyetje?

Le ta përmbledhim këtë: Ti ke marrë përsipër pyetjen: *"Kush është ky 'unë' që vuan pakënaqësi?"* Ti ke raportuar gjetjet e tua; vëmëndja largohet nga subjekti i pyetjes - "unë" - dhe bie në atë kuptim natyral, intuitiv "unë jam". Ndërsa kjo ndodh, ky "unë" i pakënaqur humbet dallimin e tij dhe zbehet në mosekzistencë. Të gjitha përvojat të njohura për këtë 'unë' kanë të njëjtin fat.

Edhe kur ky "unë" personal është tretur, atje mbet ende një ndjenjë "unë". Kjo 'unë' e mbetur është jopersonale. Ne e quajmë atë intuita "Unë Jam" për hir të qartësisë.

Në prani të "Unë jam", ky "unë" i shqetësuar, ky "unë" personal, nuk shihet si asgjë më shumë se vecse një mendim.

Pyetja ime vijuese është: A mundet kjo 'Unë jam' të vërehet?

Më duket sikur ti dëshiron që unë të shkoj edhe një hap më tej kur ti pyet: "Kush është i vetëdijshëm për 'Unë jam'?"

Ajo që po theksoj është diçka që ti tashmë e the me këto fjalë: 'Unë e di që unë jam'. Ti e di se ti je në vetëdijshmëri dhe se po përjeton përmes Vetëdijes. Vetëdija dhe funksionimi i Vetëdijes janë të perceptueshme dhe perceptuar. Kush është perceptuesi i kësaj finese madhështore?

Çdo qenie njerëzore duhet ta shijojë këtë! Lër gjithçka mënjanë. Mos kërko asgjë përmes asaj që ti mendoni se di. Edukimi yt nuk do ta mbështesë këtë. Gjithçka që ti ke lexuar dhe studiuar ndonjëherë, lëri të qeta. Lër gjithçka vetëm dhe vetëm ji. Lër gjithçka mënjanë derisa atje të ketë diçka që nuk mund të lihet mënjanë, dhe pastaj fol nga kjo hapësirë. Fol nëse mund të gesh ndonjë disharmoni ose mungesë. Njihe këtë hapësirë, këtë vënd pa vënd. Konfirmohu atje; atëherë ti do të mund të lëvizësh kudo në ekzistencë dhe nuk do të shqetësohesh askund. Zhvishu nga të gjitha konceptet që ke zgjedhur. Ki guxim të mjaftueshëm për të qëndruar plotësisht vetëm dhe për të parë nëse atje mbeten më pyetje për t'u bërë.

A mund të shohësh se gjithçka është një mendim? Gjithçka është mendim! Edhe gjëja më madhështore është vecse një mendim. Mendimet nuk mund të ekzistojnë pa ty. Ti je dëshmuar i tyre; ti je blerësi i tyre, je punëdhënësi i tyre, ato raportojnë tek ty. Kush je ti? Ti duhet ta shijosh këtë!

Trupi i njeriut është një privilegj i madh sepse na lejon të bëjmë këto pyetje. Asnjë specie tjetër nuk ka aftësinë për të kërkuar, por ne e kemi këtë, dhe për të gjetur me siguri. Nga pakënaqësia jote ti dëshiron një kënaqësi të qëndrueshme. Zbulo se çfarë largohet nga ty dhe çfarë jo. Çdo gjë tjetër do të largohet nga ty. Me dhuratën e këtij trupi, ti ke këtë mundësi madhështore për të zbuluar të Vërtetën e Ekzistencës tënde, por ti e humbet atë nëse të gjitha kërkimet kanë të bëjnë thjesht me trupin dhe përmbushjen e dëshirave të mendjes! Po, kaq shumë punë ne bëjmë për kënaqësi trupore! Por vetë trupin që ty të nevojitet për të shijuar, ti nuk mund ta mbash. Prandaj, çdo gjë që ti skllavëron në mënyrë që të kesh një shije të saj për pesë minuta, dhjetë minuta, po shpërlahet. Çfarë është ajo që nuk mund të lahet tej?

Në këtë hapësirë unë as që mund të pyes se 'kush jam unë?', ose 'kush po e observon të gjithën këtë?'.

Faleminderit! Faleminderit! Edhe këto pyetje nuk do të rrezonojnë, por ato mund të vijnë.

Në fund të fundit, në shikimin përfundimtar ti kupton se çdo gjë që është e perceptueshme është e ndryshueshme, ajo shfaqet përpara teje dhe nuk mund të mbahet me vëmendje të pandërprerë; vjen e shkon. Por çfarë është ajo që i observon këto? Kjo nuk është thjesht një pyetje mendore, kështu që asnjë përgjigje e paqartë nuk do të bëjë punë. Vetëm ato përgjigje që lindin nga mprehtësia e pastër do të mbartin atë kënaqësi të qëndrueshme. Ti je përballë me Vetën. Je përballë me veten tënde, si dukesh?

Ajo që zbulohet kur mendimet mungojnë
është gjithashtu këtu kur mendimet janë të pranishme.

AMBASADOR TË LIRISË

Vetëdija që ti je nuk ndikohet nga aktiviteti i mendjes ose trupit. Sytë e hapur apo të mbyllur, kjo nuk ndikon në Vetëdije. Shoqëria "shpirtërore" nuk e rrit vetëdijen, poashtu sikurse shoqëria "e kësaj bote" nuk e zvogëlon atë. Vetëdija nuk është një ndjenjë dhe kështu është përtej ndjenjave të mira apo të këqija. Vetëdija nuk është as personale, as jopersonale, as e jashtëzakonshme dhe as e zakonshme. Vetëdija nuk ka vëndndodhje; nuk ka asnjë ndryshim nëse ti je në Arunachala apo në ndonjë tjetër vënd në botë. Vetëdija nuk është në fund të disa përpjekjeve apo praktikave. Ajo nuk mund të ndahet me kohë apo hapësirë. Ndjenja jote intuitive e "Unë" nuk është e ndarë nga Vetëdija.

Ti je një me Vetëdijen kur "Unë" lind pa një histori apo forcë psikologjike. Ti je një me Vetëdijen që kur duke thënë "Unë" i referohesh vetë asaj intuited që është sinonim i Qënësisë. Nëse ky është pozicioni yt, ti nuk je "unë" që flet apo "unë" që dëgjon, as "unë" që dyshon dhe as "unë" që beson. Asnjë fe nuk të përket ty. Rolet që ti luan në jetë plotësohen spontanisht dhe natyrshëm, por ti nuk investohesh më në to si dikur. Ti nuk je nëna e dikujt, nuk je babai i dikujt, nuk je fëmija apo miku i dikujt. E mirë, e keqe, janë thjesht fjalë për ty. Asnjë gjykim nuk ka ndonjë rëndësi. Ti e kupton se gjithçka që vjen dhe shkon është pjesë e një marrëveshjeje paketë. Nuk janë gjë tjetër veçse shprehje njerëzore. Çdo ndjesi, çdo humor, çdo lojë e mendjes është vetëm një valë në sipërfaqen e oqeanit. Sa kohë do të të duhet për ta kuptuar këtë të vërtetë?

Shumë njerëz nuk mundën ta durojnë këtë lloj të foluri. Një i rrallë nuk trembet nga kjo ftesë, dhe kështu ai zgjohet.

Unë them, hiq të gjitha dyshimet dhe pastaj ti mund të jesh ambasador i lirisë tënde. Ti e merr këtë Liri kudo që shkon dhe je Drita për vetë Vetën tënde.

Çdo qenie njerëzore flet nga një hapësirë dyshimi, nga një krizë, nga disa telashe, nga disa shqetësime. Ajo që këtu mungon është se e gjithë kjo është

për shkak të keqidentifikimit. Je ti, Qënia – Absolutja në manifestim – që duket se ka rënë në një farë konfuzioni. Ky konfuzion është produkt i '*maya-s* (iluzionit)' tënd. Ti ke rënë nën magjinë, hipnozën e projeksioneve të tua dhe po vuan nga ky mashtrim. Gjithçka që kërkohet është një shuplakë për të të zgjuar ty - Qënien - nga ky hutim. Kjo është asjo se për çfarë satsang është për.

Ti thua; 'Ndaj dituritë e tua me ne'.
Unë nuk kam dituri për të ndarë.
Unë nuk po flas nga dituria;
Unë flas vetëm nga Qënia.
Unë jam ajo Qënie dhe
gjithashtu përtej asaj Qënie
si Vetëdije e panjohur.

SHKËPUTJE-ENERGJIE NË MËNDJE

Harro të gjitha strategjitë e mendjes tënde për të fituar njohuri dhe mirëkuptim. Vetëm harroji ato! Po, harroji ato! Pse nuk mundemi të harrojmë ndonjëherë për to?

Ti pyet se çfarë të bësh për të qënë një me të vërtetën? Unë të them gjënë më të mirë për të bërë: Merr një mënyrë të shpejtë! Harro rreth saj! Shkëput energjinë në mendje! Dritat fikur! Kjo është e vetmja strategji, nëse duhet ndërmarrë, për t'u zbuluar në çast se Liria e përhershme dhe e përjetshme është tashmë e pranishme si ty!

Këshilla 'Harro rreth saj!' duket krejtësisht e papërgjegjshme, madje naive, tepër e thjeshtë, por ajo funksionon çdo herë. Harro rreth saj!

Ndonjëherë ajo që ne ndajmë në satsang e bën mendjen të lundrojë për të kapur kontekstin e temës. Unë them: Hidhe atë jashtë! Harro rreth saj! Dhe prapëseprapë, ti je këtu, plotësisht këtu, bosh, pa strategji. Je pa strategji dhe pa qëllim. Kështu, të gjitha gjërat ndodhin bukur.

Jeta – mënyra sic ti e di atë – të mëson se si të ecësh me paterica dhe megjithatë ti je plotësisht i shëndetshëm. Hidhi patericat dhe kërce! Cilat janë patericat nga të cilat ti varesh? Nociione të tilla si këto; "Unë nuk jam i lirë", ose "Unë jam i kufizuar nga rrethanat dhe kushtet e mia", këto janë ato.

Përdor zemrën tënde, jo kokën! Vendose zemrën tënde para meje kur bën një pyetje! Unë nuk dua të shoh fytyrën tënde, duart dhe kokën tënde. Po, as kokën tënde nuk e dua. Fol dhe vepro nga ajo hapësirë e Zemrës!

Eja para meje dhe më shfaq Zemrën tënde!

ILUZIONI I VETËDIJES

Kontrolli është një obsesion i Vetëdijes kur ajo identifikohet. Identifikimi me trupin e bën Vetëdijen të ndjehet e pambrojtur. Ajo e di se trupi është i përkohëshëm, se ai mund të lëndohet dhe nënshtrohet dhimbjes, sëmundjes dhe plakjes; prandaj, duke u identifikuar si trup, Vetëdija gjithashtu ndjen se mund të dëmtohet ose të vdesë. Për më tepër, kur Vetëdija identifikohet me mëndjen, një transferim përgjegjësie duket sikur ndodh. Ajo që natyrshëm po kujdeset prej Vetëdijes, për shëmbull: mirëqënia e trupit, rehatia, veprimet dhe situatat, tani ndihet si detyrë për mëndjen e kufizuar që t'i kryejë të gjitha këto vetë. Kjo është mënyra se si Vetëdija përfundon duke përjetuar faj, turp, pendim dhe ankth. Ajo shqetësohet për bërjen e një gjëje të gabuar, frikësohet të bëjë një zgjedhje 'të keqe' ose të humbasë diçka që zbut këtë ankth të vazhdueshëm themelor të cënueshmërisë, ose fantazon për diçka që do ta lehtësojë atë. Perceptimi i mëndjes për jetën është i mbështjellë rreth betejës me këta faktorë trupor dhe për sa kohë që Vetëdija identifikohet, Ajo gjithashtu, shfaqet si e zhytur në këtë luftë.

Ti, Vetëdija, ke nevojë për këtë trup që të vazhdosh të shijosh dhe përjetosh, por nuk është e nevojshme të identifikohesh me të. Pa identifikim, trupi ende do të jetë aty dhe ky obsesion kontrolli do të zbehet.

Trupi është plotësisht i pafajshëm në të gjitha këto. Me dekret hyjnor ai është këtu duke bërë punën e tij. Trupi nuk e di se ti je. Diçka në brëndësi e mban vazhdimisht trupin si 'unë' dhe i jep atij një emër.

Mëndja duhet të ketë diçka për të të kërcënuar për të të mbajtur peng. Duhet të ketë diçka që ti dëshiron apo nuk dëshiron për mëndjen që të të bëjë të dëgjosh paralajmërimet e saj të rreme - të tilla si; *'Nëse nuk e bën këtë, diçka e pakëndshme do të ndodhëty'*. Më shpesh se jo, këtu është frika e ndryshimit, sepse mëndja imagjiron atë që ajo nuk e di - ose që ende nuk e ka projektuar - si diçka negative. Në atë hapësirë do të ketë një lloj humbjeje, ose një 'tërheqje' ose një 'kthim prapa'. E gjithë kjo mund të çojë në asgjësim, gjë kjo që mëndja e kalon gjithë kohën duke u përpjekur ta shmangë.

Ji i guximshëm me jetën, thuaj: "Mirë, më kthe në një lypës rrugësh nëse dëshiron, por unë do të jem një lypës i lirë në rrugë". Dhe pastaj do të shohësh se prej nga lëkundja vjen nga. A mund të bësh këtë? Të tjerët e kanë bërë këtë, dhe kanë gjetur kur janë përballur, se frika e tyre nuk është gjë veçse një fantazmë që zhduket në dritën e guximit dhe vullnetit të tyre për të parë me të vërtetë.

Frika është gjithmonë më e madhe se realiteti. Frika vjen për shkak të mungesës së besimit. Ti mendon se mund të kujdesesh më mirë për veten se sa Zoti mundet. Ti ke frikë se ajo që Zoti mund të ketë planifikuar për ty mund të mos jetë ajo që ti dëshiron. Kjo është ndoshta e vërtetë sepse ëndrrat që ne kemi janë të kufizuara në atë që ne dimë për jetën dhe veten tonë, e cila është pafundësisht mikroskopike deri në pafundësinë që Është. Kur heqim dorë nga ajo që mendojmë se do të na bëjë të lumtur, ne lejojmë Hirin të marrë frymë dhe gjërave madhështore dhe të bukura që as nuk i imagjinonim u jepet hapësirë për të ndodhur.

Megjithatë, kjo nevojë e dukshme për të kontrolluar, frika nga humbja e saj, dhe supozimi i daljes jashtë prej saj, është gjithashtu Vetëdija duke luajtur sepse atje nuk ka asnjë individ jashtë kësaj Vetëdije që të vendosë ose të veprojë në kundërshtim me vullnetin lejues të Vetëdijes. Gjithçka është Vetëdije. Qëniet njerëzore dhe veprimtaria e tyre janë një efekt dhe jo shkak i Vetëdijes. Mendo për këtë. A mund të përcaktojnë personazhet në kapitullin e parë të një libri se si kapitulli i dytë duhet të jetë? A mund ta urdhërojnë ata autorin të ndryshojë situatat dhe personazhet që atyre nuk i pëlqejnë, apo të parandalojnë kapitullin tjetër të ndodhë?

Për disa, të shohësh përmes iluzionit të kontrollit është një ide thellësisht represive, ndërsa tek të tjerët është plotësisht çliruese. Vetëdija nuk po të përdredh krahun. Je ftuar të shohësh.

Kush është në dijeni të kërkimit,
kërkuesit, dhe çfarë po kërkohet?
A nuk është ajo ti?

Nëse ajo që kërkohet gjendet,
a nuk je ti atje?
Nëse ajo humbet,
A nuk je ti atje?
Kush je ti?

'DHE MË PAS...'

Unë shoh në shumë prej jush se ju jeni zhveshur menjëherë në Zbrazëti. Askush nuk jeton pas atyre syve. Është e bukur. Ka hapësirë jashtë dhe hapësirë brënda, e njëjta gjë, asnjë ndryshim. A nuk mjafton kjo? Si mund të ndodhë që shumë nga ata që kanë shijuar ekzistencën e tyre si ajo lumturi e pandryshueshme kanë ardhur tek unë për të raportuar humbjen e kësaj njohjeje? Fjalët e tyre të para janë zakonisht "*dhe më pas ...*". Jam kurioz, cili është ky moment "*dhe më pas ...*"? Më sill në momentin tënd të "*dhe më pas ...*" dhe më trego se çfarë ndodh atje.

Është identifikimi me trup-mëndjen që është problem.

Në këtë ka tre faktorë: trupi, mendja dhe identifikimi me të dyja. Të tre faktorët janë të perceptueshëm, dhe ti i percepton ato. Ajo që ti e quan identifikim është një veprim - një atribut i Vetëdijes si vëmëndja ose besimi - që buron nga Vetëdija. Ti thua; "*Identifikimi i vetes sime me trup-mëndjen*". Pyetja ime për ty është; identifikimi është i kujt me çfarë? Dhe kush je ti në gjithë këtë?

Nëse ti je duke bërë hetimin tënd, duhet të jesh në qartësi në lidhje me këtë. A nuk je ti ajo që po shikon? Natyrisht, ajo që identifikohet me mendjen trupore nuk është trup-mëndje, apo jo? Pra, nëse ajo nuk është trup-mëndje, çfarë është ajo? Kur ta inspektosh këtë, do të zbulosh se trupi dhe mendja janë të pafajshëm në këtë. Ekziston një tjetër faktor krejtësisht përgjegjës.

Siç thamë në fillim, ti je në vetëdijshmëri për trupin, mendjen dhe identifikimin me të dyja. Le të hedhim një vështrim në mendje. Mendja është mendim. Ti je në vetëdijshmëri për mendimet e tua. Mendimet vijnë e shkojnë. Asnjë mendim nuk është i përjetshëm. Diçka po i shikon mendimet. Ti nuk mund ta mbash një mendim të pandërprerë. Një zë vjen: "Babi", dhe mendimi është zhdukur. Natyrisht, mendimet nuk janë të përhershme.

Mendimi i kujt është ai? Ti thua; "Ky është mendimi im". Ti nuk thua; "Ky është mendimi yt". Kjo "e imja" duhet të ketë diferencë në të. Shiko dhe vëre

nëse kjo "imja" ka ndonjë diferencë në të. Dallimi mund të përbëhet vetëm nga cilësia. Një cilësi nuk është e ndjeshme. Cilësia është thjesht një fenomen dhe një fenomen nuk mund ta njohë veten. Një fenomen është efektivisht një objekt. Diçka e percepton objektin. Çfarë është ajo që e percepton atë? A mund të jetë ajo ndryshe nga ndjenja jote intuitive për veten?

Kur të shikosh atë që e percepton objektin, do të duhet të thuash: "Duhet të jem unë, unë jam ajo që po i shikoj të gjitha këto. Unë jam ajo që shikon cilësinë". A ka ajo që shikon cilësinë ndonjë cilësi në vetvete? Nëse përgjigja jote është; "Po, ajo ka vetë cilësi", atëherë kjo vetëm do të thotë se ajo vetë mund të perceptohet. Nëse ajo mund të perceptohet, ajo nuk je ti, Observuesi i pastër. Ai është observuesi i miksuar me ndonjë cilësi, një koktej. Çfarë e observon këtë? Kur kjo pyetje është e angazhuar, diçka po kthehet përsëri në Pafundësi. Ajo po kthehet përsëri në ty. Ti je Pafundësia. Ti je ajo që është duke shikuar. Çfarë po përjeton në analizën përfundimtare të shikimit? Çfarë ka mbetur jashtë shikimit tënd? Çfarë mbetjesh ka më atje? Ky kërkim është si ndezja e një blloku kamfuri. Ajo do të digjet dhe nuk do të lërë mbetje. Nëse ti e ke bërë hetimin tënd, çfarë mbetet? Kush i mbijeton hetimit?

Ti je e Pavdekshme,
pse po mendon për vdekjen?
Le të vdesë ajo që mund të vdesë
dhe lëre të Përjetshmen të jetë.

LËRE CANTËN E GJUMIT “UNË” TË ZBËRTHEHET

Ndonjëherë, si përgjigje ndaj fuqisë depërtuese të satsang-ut tënd, përjetohet një ndryshim i fuqisë. Bëhet një kalim nga manuali në automatik. Canta e gjumit ‘Unë’ zërthehet; Qënia zvarritet jashtë ndërsa zbulon përsëri plotësinë e saj natyrore. Zbulohen energjitë e bllokuara si kushtëzimi, zakonet, frikërat, lidhjet dhe dëshirat e tua që dikur ishin pëlhura që mbanin së bashku ndjenjën tënde të një ekzistence të pavarur dhe autonome. Kujtimet e fjetura dhe tendencat ndizen për pak kohë. Ti do të përjetosh mënyra që janë të reja për ty. Prandaj, nuk është e pazakontë që shumë turbulenca mund të jenë të pranishme për ca kohë. Le të ndodhë gjithçka. Përmbahu nga nxjerrja e ndonjë përfundimi rreth çdo gjëje që ti percepton. Vetëm hesht. Le të ndodhë. Rezistoji tendencës për të interpretuar ngjarjet. Mos gjyko asgjë.

Për një kohë, mund të zbulosh se rutina e jetës tënde nuk është më fare si një rutinë. Ti mund të harrosh çelësat e tu, numrin tend të telefonit, se çfarë autobusi të marrësh për në shtëpi etj. Në mëndjen tënde mund të hyjë paniku. Sa me fat që je në satsang, një mjedis ku të kujtohet se e gjithë kjo është në rregull. Ti je e mbajtur në pëllëmbën e Zotit, ndaj mos u shqetëso se duhet të kujdesesh për veten. Ti e ke bërë atë kaq gjatë. Tani ti po mëson se si universi kujdeset për ty.

Gradualisht, ti do të ndjesh një paqe më të thellë në brëndësi që nuk shqetësohet lehtë. Humori yt do të vendoset në një lloj ekuilibri natyral. Është zbuluar se aksionet dhe reaksionet, me të cilat më parë ti ndiheshe shumë thellë në përfshirje me, perceptohen në këtë hapësirë të Vetëdijshme me të cilën ti je një me, por ti nuk je i prekur. Ka një qëndrueshmëri, një thellësi në këtë njohuri, dhe një gëzim madhështor shfaqet pa ndonjë arsye.

Paqëndrueshmëria fillestare në sferën e përvojës përfaqëson dhimbjet e lindjes teksa po rilindesh në zbrazëti. Lëre atë zbulim të ndodhë derisa të qetësohet. Ajo nuk është më shumë sesa kur një tingull një shishe e zbrazët

lëshon kur e hedh në oqean: 'blup, blup'. Sapo i gjithë ajri të dalë, ajo bëhet plotësisht e qetë dhe zhytet në fundin e oqeanit. Mëndja jote është si kjo shishe. Fillimisht bën një zhurmë 'blup, blup' derisa ajo bëhet shumë e qetë. Pra, mos u shqetëso nga këto gjëra. Ato do të ndodhin. Edhe nëse mendon se po çmendesh. Edhe kjo kalon. Këto janë vetëm flluska të vogla që dalin jashtë.

Rezistoji tundimit për të formuluar ndonjë përfundim. Kjo është mëndja që po lufton për të ruajtur fuqinë e saj. Ti e ke jetuar jetën sikur po e luaje atë nga fletët e muzikës. Tani që e gjithë letra është djegur, ti duhet të luash këngën e jetës tënde prej veshi. Nuk të takon ty të kujdeses se si gjërat janë. Shumë pak njerëz mund ta durojnë këtë. Disa mund të kthehen prapa dhe mëndja po pret me padurim të mirëpresë kthimin tënd. Por në satsang ti inkurajohesh ta durosh këtë shtrydhje dhe shqetësim. Është vetëm për një kohë të kufizuar si kjo, vetëm për aq kohë sa Qënia ka nevojë të gromësisë disa energji të vjetra, të bllokuara. Disa pastrime të brëndshme të pranverës po ndodhin. Është një shenjë e mirë.

Nëse dëshiron të pish ujë të pastër,
atëherë shko te Burimi.

FARA 'UNË JAM'

Në topin e kristaltë të vetëdijes përmbahet ndjenja e shikuesit që percepton, raporton dhe angazhohet me përvojën e diversitetit, jashtë dhe brënda formës përmes së cilës ai gjithashtu shprehet. Ndjenja "Unë Jam" është fara nga e cila e gjithë kjo mbin dhe e cila perceptohet nga ajo intuitë "Unë Jam".

"Unë jam" nuk mund të shprehet pa formën. Pa formën Ajo nuk mund të përjetojë.

Shikuesin e "Unë jam", askush nuk mund ta shohë. Ti nuk mund të përdorësh intelektin tend përtej "Unë jam". Pra, çfarë është ajo që njeh edhe vetë intelektin? Mos përdor imagjinatën tënde, imagjinata poashtu shikohet! Kush ende po mendon? Edhe tendenca jote drejt të menduarit, së bashku me vetë të menduarit, shikohet nga ajo që është përtej mendimit. Pra, çfarë është përdorimi i mendimit? Është i tepruar.

Shumë prej jush kanë frikë të pyesin përtej kapacitetit intelektual të mendjes. Ekziston një ide se 'pa mendje' është e barabartë me çmënduri, 'Nëse unë e humb mendjen time, unë do të çmëndem!'. Zbulo se çfarë po mbahet në mendje apo po heq dorë nga mendja. Sepse e gjithë kjo është mendje! Ti je Ajo në të cilën mendja përmbahet me të gjitha nocionet dhe idetë e saj, madje edhe çmëndurinë. Si mundesh ti të bëhesh i çmëndur duke zbuluar se kush ti je?

Nuk ka asgjë të keqe me mendimin. Nuk ka asgjë të keqe me asnjë objekt. Vetëm një identifikim i gabuar e krijon këtë ligësi dhe ti je këtu për të zbuluar këtë vetëmashttrim. Duke ekzaminuar 'Unë', do të zbulosh se 'Unë' nuk i përket askujt.

"Unë Jam" është Liri, "Unë Jam" është Qënie. "Unë Jam" është e papërzier, e pastër; pa "Unë Jam" asgjë nuk ekziston. Ajo është parfumi i pashuar i Hyjnores që shkëlqen në çdo trup. Ajo Hyjni në trupin tim po flet me të njëjtën Hyjni në trupin tënd. Ajo që shikon përmes syve të mi është e njëjta që shikon përmes syve të tu. Ti je për ta zbuluar këtë të Vërtetë, ajo do të

zbulojë veten. Dhe ti që e zbulon këtë dhe të cilës ajo i zbulohet, je Ajo vetë.
Nuk ka nevojë të kruash kokën për këtë. Ajo i zbulon vetes veten, jo një tjetri.

MË DELIKATE SE HAPSIRA

Kur bëhet fjalë për pikën e vetë-hetimit, nuk funksionon për mua sepse ajo ndihet shumë mentale. Në vënd të kësaj, unë e zhvendos fokusin e vëmëndjes sime në hapësirë dhe jo në objektet që shfaqen në hapësirë.

E mrekullueshme! Më parë, ti po përshkruaje atë që po ndodhte, e cila krijon një lloj klaustrofobie në Qënie. Tani, ti fokusohesh në hapësirën brënda së cilës kjo shfaqje shfaqet, kështu që vizioni yt është gjithëpërfshirës, panoramik. Kur shikimi dhe hapësira bëhen një, padyshim që bota bëhet e qetë.

A përkeqësohet apo lulëzon cilësia e jetës tënde?

Jam shumë e lumtur.

Atje tashmë ka një ndjenjë të natyrshme gëzimi dhe një relaksim në Qënie tënde. Çfarëdo që shfaqet në hapësirë, zhduket në hapësirë, e megjithatë hapësira nuk pret që ajo të shkojë. Edhe nëse ndonjë manifestim po mbush hapësirën, hapësira nuk shqetësohet. Me kalimin e kohës ajo do të kalojë. Kaq larg ti ke arritur, shumë mirë!

Tani, një hap më shumë. Në thënien 'Unë fokusohem në hapësirë dhe jo në objekt' ka një ndjenjë zgjedhjeje: 'Unë mund të shkoj me objektin ose mund të shkoj me hapësirën. Nëse unë shkoj me objektin: turbulenca vjen! Kur unë shkoj me hapësirën: qetësia është e pranishme. Më pëlqen qetësia; Mendoj se do të qëndroj me qetësinë.' Cila është kushtetuta e asaj që fokusohet dhe zgjedh hapësirën?

Ajo e di që ende është duke parë hapësirën.

Atëherë duhet të jetë më delikate, sepse ajo Pashtu mundet të shikojë hapësirën.

Ndonjëherë atje është sensi se unë jam ajo brënda së cilës ky ushtrim po ndodh – dhe më pas kjo kalon përsëri në një lloj fokusimi të kryerësit.

Vetëdija nuk mund të jetë kurrë një objekt. Ajo nuk mund të perceptohet fenomenalisht. Të jesh në ndërgjegjësim për vetëdijshmërinë e Vetëdijes,

është një veprim që ti nuk mund ta bësh! Diçka është thjesht duke ndodhur. Ajo që ti tashmë po kërkon ka ndodhur, në fakt nuk ka ndodhur; ajo është para se gjithcka të ndodhë. Tashmë është kështu, por atje ka një lëvizje që thotë: 'unë ende nuk e kuptoj' që është duke u besuar. Do të arrish të shohësh se ky "unë" që duhej ta "kuptonte atë" ishte vetë pengesa e dukshme sepse krijonte një *dikotomi* (ndarje).

Unë jam duke përdorur koncepte për të hequr konceptet e tua. Dhe kur ato të jenë hequr - konceptet e mia dhe konceptet e tua - atëherë ajo që do të mbetet është tashmë këtu, tani! Më afër se kontakti! Më afër se intimiteti! Ti po kërkon me mendje dhe mendja mund të kërkojë vetëm objekte. A mund ta gjejë mendja subjektin, në të cilin ajo, vetë mendja shfaqet si objekt?

Nëse nuk e kupton, është në rregull. Nuk është e nevojshme të ketë sens. Vetëm kjo duhet të njihet: ti po shikon për diçka, por ti tashmë po sheh prej nga ajo. Qëndro me këtë njohje. Ti ke ardhur në një vënd të bukur ku nuk je duke marrë apo shpëtuar asgjë. E ke parë qartë: Ajo që shfaqet në ekran i përket gjithashtu ekranit. Ajo vjen dhe shkon. Ndonjëherë atje është hapësirë, heshtje, qetësi. Ky është gëzimi i mosidentifikimit. Lëri objektet të shfaqen, ti as nuk po i mban dhe as nuk po i shtyn tej, ato thjesht shfaqen vetë sipas ligjeve të tyre.

Kur nuk je duke u identifikuar me objekte, menjëherë ka një ndjenjë të natyrshme gëzimi dhe paqeje. Atëherë Dashuria do të të përgjigjet: "*Tani nuk je më i preokupuar me 'të tjerët', je i disponueshëm për mua. Unë do të vij*".

Unë jam Ujërat Madhështorë.
Mbi fytyrën Time, stilolapsi
primordial i Mahamayas
shkruan parreshtur jetët dhe fatet
e të gjitha qënieve të gjalla.

Secila valë, çdo valëzim,
lëvizja më delikate - është kërcimi Im.
Megjithatë Unë – Realiteti i pastër,
mbetem gjithmonë e paprekur, e pandikuar.

E Lavdishme dhe përtej çdo koncepti,
Unë - e Paimagjinueshmja,
Absolutja pa Formë,
e Vetme JAM.

NJË TAKIM ME BUDËN

Asgjë nuk po ndodh me ty. Kjo është vecse loja jote, luajtja jote. Nuk ka asgjë për ti shkruar shtëpisë për; nuk po ndodh asgjë që do të mbushte edhe vetëm një kartolinë! E si mund të kesh frikë nga qënia jote Shiva, e cila është e zbrazët nga çdo qëllim, bosh nga koha, bosh nga shkaku dhe pasoja, bosh nga e nesërmja, bosh nga jeta dhe vdekja? Të gjitha janë zbrazur. Shiko, është thjesht një ëndërr që lind në Këtë dhe ëndrra është pjesë e Kësaj! Ëndrra është pjesë e lojës së Saj, e madhështisë së Saj! Dhe ti do të kesh hequr zhurmën tënde. Atëherë ajo që mbetet është e palëvizshme, e pandryshueshme dhe e pastër - Ekzistenca e pandashme. Nataraj!

Trupi ka frikë nga të gjitha këto!

Trupi nuk ka frikë nga Kjo, trupi është duke pritur për këtë! Duke pritur që mendja të pushojë në Këtë.

Atëherë është mendja e frikësuar.

Por ku është mendja? Mendja në vetvete është një mendim! Shikimi po ndodh, dhe shikimi bëhet bosh. Të gjitha shqisat funksionojnë, por ato heshtin. Dhe çfarë fshihet pas gjithë këtyre? Pafundësia! Pafundësia është prapa, përpara, sipër, poshtë dhe përtej gjithë kësaj!

Ekziston një virus tinëzar i mosbesimit dhe ky virus po e thith vëmëndjen. Por edhe kjo shihet. Ajo është parë si zëri që ka qënë më i afërti, ky fantazmë "Unë".

Ajo është si një mbajtje në...

Mos u identifiko me asgjë që po mban. "Mbjajtja" nuk është gjë tjetër veçse një mendim - një mendim që qëndron pas një mendimi.

Të gjitha këto janë vetëm ide! Kjo nuk je ti! Pse po fshihesh nga plotësia e asaj që ti je? Pse je e frikësuar? Ajo nuk je ti! Kur flet kështu, nuk e pranoj,

nuk të besoj! Dhe unë nuk kam asnjë interes për atë që ti flet! Sa herë që të takoj, ti je Zoti Vetë. Por ti po paraqitesh si Zoti duke mohuar veten e Tij - a është kjo e mundur?

Ti vazhdon t'i vendosësh gjërat para vetes, 'Kjo më ndalon mua!' Marrëzi! Asgjë nuk të ndalon ty! Kush të tha kështu? Ti si 'Ti' nuk ekziston veçse si një mendim. Ia vlen të takohesh me ty vetëm kur ti nuk je.

Tani kam një punë për të takuar Budën në Tiruvannamalai. Dhe jam duke pritur.

TE QËNIT MJALT

Kur kjo përvojë e drejtëpërdrejtë vjen, dicka mendon se ka nevojë për më shumë.

Inspektoje këtë nevojë për më shumë! Shiko nëse është diçka tjetër përveçse një ftesë mendimi. Idetë që ne kemi për zgjimin na mbajnë në harresë të vazhdueshme. Ne vazhdojmë të presim që diçka të ndodhë. Është sikur kemi një listë kontrolli të zgjimit me vete, të bindur se imazhet dhe nocionet tona për të Vërtetën janë të sakta. Një listë e shkurtër e ideve tona të preferuara rreth zgjimit ndaj së Vërtetës lexon diçka si kjo: 'Të gjitha problemet e mia më në fund do të kalojnë sapo unë të jem zgjuar', 'Nuk do të ndjej më dhimbje kur unë të di se kush jam', 'Liri do të thotë se unë do të jem në lumturi të vazhdueshme'. Nga kjo ne arrijmë në përfundimin se nëse shfaqen probleme në jetë, ne nuk mund të jemi aty. Nëse aftësia për të ndjerë dhimbje është ende e pranishme, ne nuk mund ta dimë se kush jemi dhe për sa kohë që lumturia nuk shfaqet, ne nuk jemi definitivisht të lirë. Këto fantazi na bllokojnë në një spirale të vazhdueshme ndarjeje. Në fakt, kjo listë kontrolluese e asaj që duhet të ketë nëse dikush është i lirë, minon vetë Lirinë e dikujt.

Ka shumë mendime të tilla që vërtiten në mëndjen e kërkuesit! Por mendimi në vetvete nuk ka fuqi. Ai është vetëm besimi yt në një mendim që i jep jetë asaj. Rrjedhimisht, ti mendon se këto pengesa ekzistojnë. Më pas ato bëhen përvoja jote, dhe nga ana tjetër e trazojnë iluzionin me të cilën mëndja më pas lufton sikur të mos ishte vetë-imponuar kurrë. Diçka duket se është e zakonshme për të përjetësuar dhe mbajtur ndjenjën e një vete të pavarur.

Unë mund të shoh se nuk kam nevojë për mendim, por gjithsesi ai është aty.

Pra, lëre mendimin të jetë aty! As mos u përpiq ta largosh atë. Injoroje! Kjo është ajo që të urtit kanë bërë. Ata gradualisht i shpërfillin sugjerimet e mendimit jashtë ekzistencës. Duke mos i kushtuar vëmendje këtyre mendimeve të kushtëzuara dhe të përsëritura, ka qartësi kur një mendim i pastër del nga zbrazëtia. Asnjë ankth apo nevojë nuk lidhet me të. Mendimi i pastër është pa peshë në kuptimin që nuk ka një axhendë të fshehur; është i

gjallë dhe rrjedh në veprim në mënyrë spontane. Dhe nuk kërkohet asnjë trajnim për të dalluar të dyja. Detyra jote e vetme është: Kur shfaqen mendimet që thonë: 'Eja me ne', ushtro fuqinë për të kuptuar se ti je vetëm shikimi. Ftesa më pas humbet tërheqjen e saj dhe dallueshmëria e natyrshme lind nga qetësia që mbetet.

A është vërtetë kaq e thjeshtë? Po, kaq e thjeshtë është me të vërtetë. Ja pse mëndja jote e refuzon me këtë dekret: "Kjo nuk është mjaftueshëm!" Përgjatë shekujve, të urtët, në mënyrat e tyre unike, kanë zbuluar këtë shkak të përhershëm të vuajtjes njerëzore: Ti dëshiron të shijosh mjaltin; ti nuk do që të jesh mjalti.

Mjalti nuk mund të shijojë mjaltin! Është e pamundur. Për shkak se ti dëshiro të vazhdosh ta shijosh atë, rruga drejt së Vërtetës nuk mbaron kurrë. Kjo është arsyeja pse ti je e tërhequr kaq shumë nga 'Shtatë Hapat Drejt Lirisë'. Dhe pas hapit të shtatë, ti vazhdon të prezantosh edhe më shumë; të gjithë librat dhe rrugët dhe praktikrat e ndryshme shpirtërore vijnë për të të shërbyer. Ti i përdor ato për të shtyrë këtë zbulim të Vetes tënde, e cila është e menjëhershme. Të gjitha shijet e ndryshme janë aty ku qëndron interesi yt dhe kështu e vërteta të shmanget. Ti thua se do Lirinë, por ti do liri me këste. Liria Është. Ajo nuk mund të ndahet në pako ose hapa të rregullt.

Ti pyet: "Cili është qëllimi i të qenit i lirë nëse nuk ka shije?" Të gjitha qëniet janë të varura nga shija e përjetimit: kontrasti, fërkimi, tensioni, paparashikueshmëria, drama, premtimi. Edhe dështimin, ti e do.

Të urtët gëzojnë më pastër; pa lidhje, pa varësi, pa mall, pa nevojë, pa krahasim. Kënaqësia e tyre është e freskët, ashtu siç ti e shijojë si një fëmijë shumë i vogël. Të urtët e shijojnë botën, por nuk e vuajnë atë. Një eksperiencë është vetëm një shije që kalon në trupin e Gëzimit që ata janë. Nuk investohen vetë në përvojë. Pra, nuk ka asgjë për të fituar prej saj dhe asgjë për të humbur. Ka një lumturi që është përtej shijimit të mjaltit. Të Jesh Mjalt, kjo është më e larta!

Ajo që thotë:
"Mëndja ime është shumë e fortë",
është vetë mëndja.
Një iluzion,
i forcuar nga besimi.

KUR DHIMBJA DHE PAQJA JANË NJË

Unë dua t'i rikthehem kësaj përvoje 'Unë jam Ajo'. Atje kishte vetëm paqe dhe tani ndiej kaq shumë tension!

Tensioni do të thotë vetëm se tensioni është i pranishëm, asgjë më shumë. Çfarë etiketash po i fikson tensionit tënd që e bëjnë atë një fenomen kaq domethënës dhe të pakëndshëm për ty? Ai nuk ka pse të të shqetësojë. Është shumë e mundur të jesh shumë e tensionuar dhe njëkohësisht, të jesh një qind për qind e qetë.

Por kishte aq shumë dhimbje këtë mëngjes gjatë meditimit sa që nuk munda të fokusohesha në pyetjen 'Kush jam unë?'.

Ndoshta kjo pyetje nuk ishte ajo që kërkohej në atë kohë. Ndonjëherë bëhet fjalë vetëm për të lejuar çdo gjë që ndodh; pa gjykuar, pa u shtyrë, pa u mbajtur dhe pa e kthyer atë në një ngjarje. Ti ndjen dhimbje, dhe çfarë pastaj?

Do të doja ta ndaloja atë dhe të ndihesha mirë!

Kjo dëshirë që ajo të ndalet është ajo që po shkakton telashe! Dhimbja le të jetë aty, shikoje atë! Ky është një hetim i vërtetë. Kur dhimbja, qoftë ajo emocionale apo fizike në shprehje, zmadhohet në intensitetin më të madh, atëherë ti ke mundësinë madhështore për të parë atë që ti nuk je! Kjo nuk do të thotë se ti zgjedh të martirizosh veten ose të neglizhosh shëndetin e trupit. Nëse duhet thirrur një mjek, mirë, bëj atë që duhet të bësh, por në të njëjtën kohë shfrytëzoje plotësisht mundësinë për të parë dhe shikuar. Dhe nëse nuk ka asgjë për të bërë, është esenciale të dorëzohesh në dhimbje. Luftimi i saj vetëm e ekzagjeron shqetësimin. Për mua është e qartë se ti po i jep një interpretim kësaj përvoje që po e bën atë më të zhurmshme, më të mjerueshme dhe të pakëndshme.

Për shkak të energjisë së shenjtë të këtij mali të shenjtë, Arunachula, ose zjarrit të satsang, disa reagime fizike dhe emocionale ndodhin me rritjen e virilitetit. Sëmundjet trupore janë më të pakëndshme dhe dobësuese, ndërsa emocionet janë më të forta. Ky ekzagjerim e bën të vështirë për mendjen që të shpërqëndrohet nga "paqetësia" që ajo ndjen. Ajo është e

detyruar të përballet me atë që ajo do të preferonte të shtypte, ose të ikte nga. Ty po të jepet mundësia perfekte, e personalizuar për të qëndruar në heshtje dhe për të vëzhguar se këto simptoma, si të gjitha fenomenet e tjera, do të kalojnë. Çfarë Hiri!

Le të ndodhin reagimet. Jepja ekzistencën tënde Ekzistencës. Unë po të them, eja në shtëpi. Gjithçka që ti ke frikë se mos humb është duke të të mbajtur në këtë dhimbje.

Thuhet se peshqit nuk mund
të jetojnë në ujë shumë të pastër.
Në mënyrë të ngjashme,
mendimet nuk mund të lulëzojnë
kur vëmëndja është e zhytur në Vete.

HAVIARI I QËNIES

Vërejtja jote e më hershme në lidhje me dhimbjet e lindjes që vijnë kur ne lindim në zbrazëti, që dukej si nevoja për të kaluar nëpër ferr për të arritur në parajsë më irritoit vërtetë. Pyes veten se sa vite do të duhen?!

Kur ti fillon të jetosh nga përvoja jote, nga vetëvarësia jote, këto janë vite të shkëlqyera. Për kaq shumë kohë ti ke kultivuar një mënyrë që dukej se funksiononte në botë, por ajo nuk ishte e mjaftueshme. Diçka mbeti e uritur për kënaqësi të qëndrueshme. Nëse nuk do të ishte kështu, a do të kishe ardhur këtu? Pavarësisht nga çdo rezistencë dhe frikë e mëndjes tënde, ti gjete rrugën tënde këtu. Ti mund të besosh se kjo Fuqi që të solli këtu tani po kënaq veten, po e largon këtë mëndje ëndërrimtare. Sigurisht, acarimi do të shfaqet, sepse ti nuk mund të mbështetesh më në fuqinë tënde, gjithçka në të cilën ti më parë mbështeteshe, tani po të lë. Kufijtë e tu, siguria jote dhe sistemi yt i mbështetjes së jetës, gjithçka të është hequr. Diçka, thellësisht e mërzhitur për këtë, po bërtet, 'Dua lirinë, por jo nëse është e dhimbshme dhe sjell siklet!'. Ti e dëshiron atë në një formë pilule, në mënyrë që t'i bësh të gjitha sot!

Frika nga humbja e identitetit, frika nga humbja e kontrollit, frika e braktisjes, frika e heqjes dorë nga ëndrrat e tua, frika e humbjes së lidhjeve të tua vijnë si gjarpërinj për të të frikësuar ty. Ato e marrin fuqinë përmes vëmëndjes tënde. Ti i mbështet ato sepse ato mbajnë një formë kuptimi për ty, dhe kështu të aktivizuar, ato fillojnë të ngacmojnë paqen tënde. Por ajo që Është, nuk është e vështirë të gjendet – jo, Ajo që Është është këtu edhe tani në këtë moment! Vetëm se zbulimi i kësaj të Vërtete duket se kërcënon lidhjet e tua të kësaj bote. Ti nuk e kupton se gjithçka që ti ke frikë të heqësh dorë nga, nuk është asgjë! Ajo duket madhështore vetëm në mëndjen tënde! Hendeku i dukshëm mes vetes dhe Realitetit është vetëm distancë e një koncepti.

Nëse të dhëmb shumë për t'i lëshuar këto, atëherë mos e bëj, përkundrazi provo diçka më të butë: Hidhi një sy se pse po i mban ato, dhe edhe nëse kjo

është shumë e vështirë për ty, atëherë zbulo se kush është ai që po heq dorë nga to dhe kush, ai që po i mban ato? Edhe këtë nuk dëshiron ta bësh? Ndiresh në kërcënim edhe nga kjo pyetje?

Vetëm ajo që është e pamundimshme mund të quhet e natyrshme. Ajo që ti do është pamundimshmëria. Nevojitet përpjekje për të ndjekur gjithçka tjetër përveç Asaj që Është, dhe ti nuk mund të ndjekësh Atë që Është sepse ti tashmë je Ajo që Është.

Ndoshta hezitimi yt është i rrënjësor në ide se çfarë vetë-zbulimi do të të sjellë. Nëse të është hasur të dëgjosh se liria është njësoj si zbrazëti, ti ndoshta fillon dhe pyet veten se çfarë është e lirë rreth kësaj? Asgjë nuk po ndodh në zbrazëti. Kjo nuk është shumë tërheqëse për mendjen, sepse për mendjen kjo do të thotë vdekje, por ne nuk po të ftojmë ty të hysh në versionin se çfarë mendja projekton rreth zbrazëtisë. Ne po të drejtojmë drejt përvojës direkte të Zbrazëtisë dinamike, Vetes. Në çastin që ti e zbulon këtë, nuk do ta mohosh më asnjëherë sepse tashmë po hyn në Qënien tënde primare, Gëzimin tënd parësor; më në fund edhe etja për kënaqësi të qëndrueshme shuhet. Në cilën anë të zgjimit po dëgjon vallë? Unë po flas direkt me atë Që Është. Unë po flas nga Ajo në Vetë Atë.

Nuk është nevoja të shkohet në ndonjë pelegrinazh për të takuar veten. Nuk është nevoja të bëhet ndonjë gjimnastikë shpirtërore për të qënë vetja. Pse duhet të jetë kjo gjë zhgënjyese? Për kë është kjo zhgënjyese? Ti duhet ta zbulosh këtë! 'Ti' nuk mund të jetë në frustrim! Ti je në vetëdijshmëri për zhgënjimin kur ai shfaqet si njëfarë energjie. Ajo brënda së cilës perceptohet energjia e zhgënjimit nuk është dhe nuk mund të frustrohet asnjëherë! Unë po të tregoj haviarin e Qënies, por ti po e kthen atë në ushqim për mace!

Mbahu vetëm në ndjenjën e thjeshtë
të ekzistencës – “Unë Jam” – atjo intuitë
e ëmbël dhe pa Formë në brëndësi.
Mbaj qetësi derisa ai që mban ...
zhduket.

QËNIA ORIGJINALE

Unë jam një mësues, por strukturat në shkolla janë të bazuara në mendje akademike dhe unë kam rënë në një vënd më të thellë se kaq. Dilema ime është se a duhet unë të qëndroj apo të nderoj atë që ndodh në brëndësi, apo ka ndonjë gjë diku në mes?

Përgjigja për mua është shumë e qartë. Ti duhet të shkosh thellë me thirrjen e Zemrës tënde dhe duhet ta bësh atë plotësisht, në mënyrë që të mos përpiqesh të notosh dhe të ecës në plazh në të njëjtën kohë, kjo nuk është e mundur. Ndonjëherë, dilema thellohet edhe më shumë kur ndihet se njeriu nuk duhet të largohet nga sfida, 'Me siguri ka një mënyrë që të sjell më shumë cilësi të zemrës në këtë hapësirë.' Por kjo nuk është domosdoshmërisht ajo që kërkohet nga ty.

Lëre të shkojë sa më shumë që thirrja të lejon, në një hapësirë më të thellë kuptimi dhe njohurie. Dorëzohu realisht asaj Fuqie, e cila tashmë ka vënë në lëvizje thirrjen dhe tërheqjen drejt vetes. Kufizimet tona njerëzore të perceptimit nuk mund ta kuptojnë kurrë me të vërtetë mençurinë e Saj.

Kjo Fuqi nuk është e ndryshme nga Vetja jote. Çfarëdo që ajo bën, ti do të arrish të shohësh se është në harmoni të përsosur. Sa më shumë ta përthithësh këtë dhe të kthehesh në shtëpi, edhe pa përpjekje ose qëllim, të tjerët do të përfitojnë disi nga ekzistenca jote, dhe në mënyra rreth të cilave ti ndoshta as nuk je në dijeni rreth! Kjo është fuqia e Heshtjes. Në praninë e atyre që banojnë në Qënien e tyre origjinale – të cilët janë të lirë nga mendimi i kufizuar dhe identifikimi i kufizuar – ndodh një efekt i tillë, një ndikim i tillë, një bukuri e tillë.

Ti nuk je asgjë tjetër veçse Qënia origjinale. Ke ardhur për ta zbuluar këtë, kështu që mos lejo që asgjë të të vonojë. Nuk ka asgjë më të denjë për t'u zbuluar në këtë formë sesa të dish se kush ti je. Ti nuk po e tradhton profesionin tënd, dhe kështu çdo mbështetje do të të jepet.

Beso, se jeta të mban kur ti bën një hap të tillë. Kjo nuk është thjesht teori - është e mundur të zgjohesh, të jesh plotësisht i lirë nga vuajtjet, pa dyshime

dhe pa frikë. Nga ana tjetër, ti u sjell paqe njerëzve që përpiqen të të pengojnë në udhëtimin tënd në radhë të parë.

Çfarë mund të pengojë ty kur kërkimi yt është për çlirim total nga kushtëzimi? Lidhu me të Vërtetën dhe jeta përafrohet me ty. Hiri është aleati yt dashamirës dhe i vazhdueshëm.

Jeta nuk është aq e pasjellshme sa për të lejuar
të gjitha ëndrrat e tua të realizohen.

FSHEHJA NË JASTËKUN E ZOTIT

Unë dua të arrij atje.

Të lutem shqyrtoje këtë "Unë dua të arrij atje". Në pamje të parë ky duket një mendim shumë i favorshëm, por shoqëruesi, i padukshëm në anën tjetër të medaljes, është homologu i tij i heshtur, 'Unë nuk jam aty, jam e ndarë'. Të dyja palët bashkëjetojnë, duke ushqyer mëndjen tënde së ndarjes konceptuale. Pra, mos prek asnjërën anë të medaljes. Mos e prek fare këtë monedhë. Hidhe atë larg. Çfarë mbetet tani?

Dhe përgjigjen unë nuk e dua! Është pyetja ajo që ka rëndësi. Është një pasqyrë e përsosur. Lëre pyetjen të shpaloset dhe të reflektojë në brëndësi të qënies tënde. Mos mendo për këtë! Ne jemi kaq të mirë në marrjen e monedhave të tjera me vulën "Unë" në to, në përpjekje për të arritur diku ose për të marrë diçka. Mos hyr fare në asnjë lëvizje, sado delicate ajo qoftë. Ku duhet të shkosh? E vërteta ka qënë gjithmonë këtu, më e menjëhershme se çdo mendim, më intime se vetë fryma.

Çdo ndjenjë që shfaqet nga ky introspeksion, mos u identifikoj me të. Të gjitha emocionet, poashtu si mendimet, janë turistë dhe jo qiramarrës. Ekzistoj vetëm përmes syve të tu. Po të pyes përsëri, çfarë mbetet?

Nëse dicka thotë se ajo nuk është tashmë këtu, hidhe atë! Pritja nuk është e përshtatshme. As pritshmëria nuk është; ajo që po pret është gjithashtu mëndja. Ajo që vëzhgon pritshmërinë e mëndjes është përtej pritshmërisë. Asgjë nuk mund të hyjë mes teje dhe saj. Asgjë nuk mund ta errësojë atë.

Tani ka paqe dhe qetësi.

Unë nuk të besoj ty! Energjia jote nuk po e përcjell këtë. Ti je ajo brënda së cilës paqja dhe qetësia shfaqet. Paqja dhe qetësia janë parfumi i asaj Lule pa parfum që ti je. Mos krijo, mos imagjino.

Unë me të vërtetë nuk di se çfarë të bëj.

Edhe atje, në dhomën e gjumit të vetë Hyjnores, ky 'Unë' është ende atje. Fshehur nën jastëkun e Zotit!

Unë dua të largohem.

Lëre këtë 'Unë' që dëshiron të ikë, le të ikë dhe ti rri! Pse të lidhesh me këtë gjarpër që të pëshpërit në kokë për gjithë këto vite? Identifikoheje këtë që thotë: "Dua të largohem". A je ti ajo?

Dua të qëndroj.

Ky zë gjithashtu nuk është i yti, për aq kohë sa ai ndihet si i yti, do të ndjesh se ti duhet të largohesh. Ajo është thjesht një tjetër monedhë 'unë dua' për tu hedhur mënjanë. Lëri të qeta këto gjykime dhe identifikoj, 'Ky zë nuk është zëri im. Diçka në brëndësinë time dëshiron të shkojë, por unë po qëndroj.' Si çfarë po qëndron ti? Dhe a ka ndonjë përpjekje në këtë mbetje? Një person nuk mund të mbesë, vetëm ajo që mbetet, mbetet. Dhe ti je Ajo.

Hiq dorë nga ideja e një udhëtimi drejt së Vërtetës dhe e Vërteta zbulohet në çast. Hiq dorë nga kjo ide se ti je afër. Ky koncept do të të çojë në një tjetër lindje, një tjetër mundësi. Ajo është në vetvete një shmangie. Dhe ky budallallëk, 'unë ende nuk e kuptoj', mos i kushto vëmëndje zërit të këtij gjarpri.

Hesht; le të shohim nëse je në gjëndje që vetëm të qëndrosh në qetësi. Marrëdhënia jote e ligët me mëndjen si mjeshtër ka marrë fund. Mëndja mund të përdoret për shërbim normal, por ajo asnjëherë nuk mund të të ndihmojë të jesh ajo që ti je.

Nuk kërkohet asnjë filozofi marramëndëse për të njohur Vetën, vetëm ky pasqyrim. A e ke guximin të shikosh në këtë, në pasqyrën tënde? Atje ishte një kohë kur ti nuk ishe gati të shihje. Tani, diçka të sjell ty këtu; Hidhi një sy. Hidhi një sy ose largohu.

Nëse bën atë që është e drejtë nga Zemra jote,
ajo nuk mund të rezultojë e gabuar për dikë tjetër.

HEQJA E KATARAKTIT "UNË"

Asnjë pyetje nuk ka mbetur.

Kur nuk ka pyetje, paqja mbetet.

Po, ka paqe, por nuk mundem ta përshkruaj dot.

Askush nuk mundet ta përshkruaj dot këtë paqe! Askush nuk ka mundur ta përçojë këtë me fjalë sepse ajo është përpara fjalëve, e sheh? Nëse ti prek mëndjen tënde, mëndja do ta dekorojë më tej këtë material të gjallë manifestimi. Ajo do të shtojë një interpretim të mbushur-egoik, të tilla si ndjenja, dëshira dhe rezistenca. Këto shtrembërime janë shtresuar në shikimin tënd origjinal. Gjithmonë bazuar në "Unë", këto interpretime krijojnë botën e dualitetit, të "tjetrit", dhe më pas frika dhe paplotësia mirëpritën të bëhen një realitet në dukje.

Kur je në liri nga nevoja për të gjykuar ose identifikuar, asnjë energji nuk rrjedh nga shqisat; ato qetësohen, dhe vetëm perceptimi i pastër mbet. Kur kjo gjëndje është e pranishme, ti nuk është se flet shumë, por nuk je kurrë në gjëndje lodhjeje. Ti nuk dëshiron asgjë; dhe kur nuk dëshiron asgjë ti je e lirë! Asnjë pritshmëri, asnjë pritje, asgjë për të refuzuar. Heshtja natyrale, paqja natyrale janë të pranishme. Unë po i flas pikërisht asaj gjëndje brënda së cilës mëndja dëshiron të bëjë diçka për të: 'Çfarë më shumë më duhet të bëj?', 'A duhet të meditoj më shumë?'. Ti je tashmë Ajo! Ti nuk mund ta përmirësosh atë! Ajo është vetëm në pritje të njohjes. Dhe, çfarë do ta njohë atë madje? Vetë njohja lind prej Saj. Pra, pa mundim, pa hequr dorë nga pyetjet, pyetjet largohen nga ty.

Ndjenja jote intuitive e Vetes lind nga Asgjëja.

Ajo thjesht është, shfaqja e vetvetes. Ajo është lumturi dhe trishtim.

E megjithatë, ajo është edhe përtej tyre. Ajo luan nëpërmjet tyre në manifestim. Edhe kjo Heshtje është përtej heshtjes, e sheh? Është Vetja. Ajo është Vëndbanimi yt, por asgjë, asnjë "gjë" nuk qëndron atje. Ajo është

referuar si Buda-Natyrë, por asnjë Buda nuk është atje. Unë jam 'ti' dhe unë jam 'Unë', dhe madje unë jam edhe përtej këtyre.

Ne jemi larguar për të gjetur atë e cila nuk mund të njihet në mënyrë fenomenale dhe që përjetohet spontanisht pa fjalë, sepse ajo është një Hapësirë pa fjalë. Ky pyll i identifikimit konceptual, ka eklipsuar njohjen intuitive që e cila është e heshtur dhe poashtu edhe vetë Heshtja. Ne duhet të kalojmë disi përmes këtij pylli dhe më pas të dalim nga ana tjetër. Herë pas here, një Krisht del jashtë, një Buda del jashtë. Ndonjëherë njëri prej nesh pengohet dhe kthehet përsëri brënda. Por disa dalin, dhe të dalësh prej saj do të thotë të kuptosh se unë nuk jam ai që po luftoj mes pemëve. Unë nuk jam banor i pyllit. E kam ëndërruar atë disi dhe megjithatë është i lidhur me mua. Ajo nuk është përkufizimi i asaj që Unë jam, por disi është shprehja që lind nga Vetja ime. Tashmë ajo dihet se nuk është Absolutja, është thjesht një lojë në të cilën po besohet në.

KUDO QE UNË JAM, UNË JAM QETËSI

Unë nuk kam një përgjigje standarte për pyetjet. Atje nuk ka një përgjigje standarte. Nuk bëhet fjalë vetëm për t'iu përgjigjur pyetjeve, por edhe për t'iu përgjigjur pyetësit, dhe kjo e bën ndryshimin madhështor.

Ti mund të besosh në Zot, por ti nuk mund të 'besosh' në Vete; ti vetëm mundesh që 'të jesh' Vetja. Qënia jote është plotësisht e heshtur, nuk shqetësohet për konceptet dhe problemet. Vetëm mendja shqetësohet, jo Zemra. Nëse qëndron në sferën e mendjes, nuk do të arrish asnjëherë plotësisht në sferën e Qënies tënde.

Ky është zbulimi kryesor: Kudo unë që shkoj, nuk jam kurrë jashtë Vetes.

Asgjë që unë mund të bëj, ose të mos bëj, nuk mund të ndikojë në atë Vetëdije të Vetes.

Ajo Unë Jam.

NJË PA HISTORI

Herën e fundit që unë erdha këtu përpara teje për të bërë një pyetje, zemra ime filloi të rrihte aq shumë saqë nuk guxoj të bëj një tjetër pyetje këtu sot. Unë thejst doja të vija këtu përsëri vetëm për tu ulur për 2 ose 3 minuta.

Pse të mos qëndrosh përjetësisht?

Unë dua të qëndroj përgjithmonë këtu, por kjo varet shumë prej teje.

Jo, kjo nuk varet prej meje. Ti nuk mund të qëndrosh në këtë plan fizik përjetësisht. Pse dëshiron që të qëndrosh kudo për ndonjë kohë të caktuar? Pse të mos qëndrosh diku përjetshësisht? Edhe të thuash 'të qëndrosh' nuk është e vërtetë. Ti nuk mund të qëndrosh askund që është e përjetshme. Ti vetëm duhet të heqësh qafe 'ti'. Atëherë do të shfaqet ajo që është e përjetshme. Atje ku është një "ti", ka kohë dhe telashe.

Ky 'unë' personal, ky 'mua', është si gishti i thyer, dhe se kudo që shkon ai shkakton telashe, çdo gjë që ai prek ndjen dhimbje. Ai që identifikohet me "Unë" mendon se çdo gjë që ndodh në jetën e tij shkaktohet nga mjedisi i tij duke përfshirë njerëzit përreth tij. Ai të thotë: "Të tjerët më shkaktojnë dhimbje mua", "rrethanat e jetës sime janë përgjegjëse". Kjo është e pafund. Shumë pak e shfrytëzojnë rastin, ose që janë të interesuar të zbulojnë burimin e telasheve të tyre, vuajtjet e tyre.

Unë të them, është ky "unë", "unë" është shkaku i telasheve të tua. Është për shkak se ti ke ndërtuar follenë tënde brënda ndjenjës së një "unë" personal që ti je kushtëzuar të vuash. Mos e rregullo jetën tënde por gjeje këtë "Unë" dhe shiko se çfarë ndodh. Sa mundet të zgjasin problemet e tua?

Kur ti thua "unë" dua të jem këtu për tre minuta, tre minuta me shumë siguri do të marrin fund, dhe çfarë 'unë' do të ketë fituar?

Ti, siç Unë të njoh ty, je e përjetshme, dhe Unë e dua shoqërinë me Të. Fol si Vetëdije. Më fol si Vetëdije dhe jo si person. Mbi 8 miliardë qenie njerëzore flasin mbi bazën se ata janë një person, bisedat e tyre i kanë rrënjët në idenë se 'unë jam një person dhe ti gjithashtu je një person', 'Kjo është jeta ime',

'Kjo është ajo që unë kam arritur', 'Unë të tregoj jetën time; ti më trego tënden.' Kush dëshiron ta dijë? Jeta e kujt është kaq interesante? Fol si Vetëdije! E freskët! Mos fol nga e kaluara! Çfarë e mirë është e kaluara? Askush nuk e dëshiron atë. Askush nuk e ha ushqimin e djeshëm. Askush nuk e lexon gazetën e djeshme. Pse duhet të flasësh për të kaluarën? Mos fol as për të ardhmen! Ka diçka që është aq e freskët sa nuk mund të ketë asnjë histori së kësaj Tani. Bëhu Një që nuk ka asnjë histori!

Unë nuk shoh askënd që është i lidhur. Dhe vazhdoj të të pyes se ku je ti e lidhur? Pse thua, "Unë jam e lidhur?" Pse thua, "Unë dua të jem e lirë?" E kuptoj këtë lutje dhe ndihem thellësisht i prekur. Le të kontrollojmë dhe të shohim nëse mund të përcaktojmë se cili është problemi në të vërtetë. Ajo që ne do të zbulojmë është një bindje se gjithçka nuk është mirë. Dhe kur ta kontrollojmë këtë për të zbuluar pse, do të zbulojmë se ka një identifikim me vdekjen. Po identifikohesh me diçka që nuk qëndron, që nuk ka jetëgjatësi. Ti ke rënë në dashuri me kohën. Ti ke rënë në dashuri me objektet, me idetë në shërbim të asaj që është kalimtare. Kështu vijnë telashet. Kështu ka hyrë konfuzioni në Qënien tënde.

Forca e jetës
rrjedh pa mundim.
Përpjekja shfaqet me idenë
se atje është një "dikush"
që ka një veprim për të kryer.

GJUHA E NJËSHMËRISË

Deri nga mbrëmja e djeshme unë ndiej në zemër se jam i bashkuar me të gjithë njerëzit. Ndihem si një gjilpërë e vogël në tabelë në shërbim të ekzistencës. Kjo ndjesi është plot emocione dhe trazira. Ka dridhërima dhe shqetësim. Është sikur duhet ta lë të shkojë, sepse në këtë ndjesi ndiej se ka një rrezik për egon time.

Kam dëgjuar njerëz që e kanë thënë këtë edhe më parë: "Unë kam pasur këtë përvojë dhe tani ne jemi të gjithë një së bashku". Dhe unë dua të të pyes, ne jemi një si çfarë? Në çfarë mënyre jemi "ne" një? Ne ende po e mbajmë "ne-në" tonë. Çfarë është kjo 'ne' që është një, dhe një me çfarë? Kjo është ajo që unë dua të di. Unë dua të zbuloj nëse ti ke mësuar dialektin e Njëshmërisë, por në të vërtetë një ide që "ne" plus "ne" është e barabartë me një, vazhdon ende për ty.

Mos e hidh poshtë këtë përvojë. Ajo është mirë. Diçka po zbulon përmes kësaj një të vërtetë më të madhe. Ndoshta qëllimi yt më i thellë rreth të ardhurit përpara është të sqarosh një interpretim që ty po të vjen dhe që ende është i paplotë.

Ndjenja e Njëshmërisë nuk shkon rrotull duke mbledhur të gjitha qëniet për t'i sjellë ata në 'Klubin e Njëshmërisë'. Ndjenja e Njëshmërisë është ndjenja e Unitetit të Qënies. Njëshmëria nuk i referohet ndjenjës se unë jam njësoj si të gjitha qëniet. Jo, aspak. Ajo është më tepër si; ndjenja që Unë si një entitet individual nuk mund të gjëndet. Dhe në vënd të këtij konstatimi të mosekzistencës sime ka një ndjenjë intuitive se ekziston vetëm Kjo! Kjo! I gjithë spektri i botës eksperimentale është ajo që Unë jam dhe madje edhe përtej kësaj!

Më lejo ta përsëris këtë! Nuk është se ekziston një "unë" që është një me të gjitha "unë-t" e tjerë në botë. Jo, është se "Unë" si një entitet psikologjik, i cili mbart një ndjenjë të kryerjes së pavarur, nuk gjëndet dhe në vënd të saj shfaqet një ndjenjë Uniteti. Ajo që kuptohet është se vetëm Vetja është këtu. Vetëm Vetja e pastër është këtu. Nuk ka dy karrige në zemrën tënde, një karrige e madhe për veten e madhe dhe një karrige e vogël për veten e vogël.

Ekziston vetëm Vetja, e sheh? Është nga këtu që një ndjenjë e "të tjerëve" formohet. Të gjitha janë forma të Vetes së vetme.

Sapo ky Bashkim me Veten të jetë bërë realiteti yt, ajo që dikur ti e perceptoje si një person tjetër do të jetë turbulluar në asgjë më shumë sesa një aromë unike e Vetes. Ti do të perceptosh të njëjtën Vete në të gjitha qëniet. Ekziston një thënie, 'Unë nuk po e shoh botën ashtu siç ajo është, Unë po e shoh botën ashtu siç Unë jam.' Me fjalë të tjera, kur ti je Vetja, atëherë 'tjetri' është gjithashtu Vetja, sepse Vetja nuk sheh 'të tjerë'.

Sipërfaqësisht ne mund të vazhdojmë të flasim gjuhën e ndarjes dhe të paraqitjes. Trupi shihet dhe ndjehet dhe një sasi e caktuar kushtëzimi dhe edukimi do të vazhdojë ende në lojën e ekzistencës që ne e quajmë jeta jonë. Ti ende do t'i njohësh fëmijët e tu; nga jashtë, ti ende mund të kesh të njëjtën karrierë. Vetëdija vazhdon të luajë kështu, por e gjitha kjo shfaqet brënda një shikimi dhe kuptimi më të thellë- se të gjitha këto janë vetëm paraqitje në mua. Trupi gjithashtu njihet si një paraqitje brënda Vetes që Unë jam. Ky nuk është një mësim. Do të ketë një siguri të thellë intuitive në këtë për ty, sepse ndjenja "Unë jam trupi" zëvendësohet thjesht me intuitën "Unë Jam". Në mënyrë misterioze, në këtë njohje, bindja e lehtë se Unë jam e përjetshme dhe ajo që është këtu është e përjetshme lind natyrshëm.

Nga ky këndvështrim, gjithçka bëhet kjo Ekzistencë spontane. Nuk ka vënd për asnjë ide si përshëmbull; të jesh shërbëtor i Perëndisë – një nocion që duket mjaft i përulur, por ka edhe një ego të 'shërbëtorit të Perëndisë'. Zoti nuk është i pafuqishëm, që të ketë nevojë për ndihmën e qënieve njerëzore. Ai nuk bërtet: "Ndihmë! Ndihmë! Më ndihmo ta bëj këtë gjë, të lutem!"

Pra, ji në qetësi dhe kuptoje të Vërtetën e Njëshmërisë tënde.

Liria është falas, por jo e lirë.
Në fakt, ajo është e paçmuar.
Ajo do të të kushtojë ty
botën tënde, lidhjet e tua,
jetën tënde - veten tënde.
Ti do ta paguash këtë pa pushim
derisa të jesh mbaruar nga gjithçka që 'ti' ke
dhe cdo gjë që 'ti' ke ruajtur.
Ti do të shkëmbesh të gjitha këto
për atë që "ti" nuk mundesh ta kesh
– Qënien tënde të përjetshme.

HIQ DORË NGA FIRMA

Kush qëndron pas gjithë këtij manifestimi? Shiko dhe do të zbulosh se ai po vazhdon vetë! Kur ti e sheh këtë, atëherë vetëdija jote bëhet e papushtuar. Deri atëherë, ajo është duke u pushtuar nga kuptimi i kryerësit, 'unë duhet të bëj diçka, unë duhet të kuptoj'.

Kërkohej përpjekje për t'u bërë, por çfarë përpjekje kërkohej të bëhet? Pra, qëndro si ajo që mbetet; observues i Ekzistencës spontane. Ajo nuk është kaotike. Çfarëdo që ndodh, ajo vazhdon dhe e bën këtë mjaft mirë. Menaxheri i supozuar - mendja - po shkakton shumë telashe. Dhe jo, ne nuk po shkarkojmë vetëm menaxherin, ne po heqim dorë nga firma!

Shiko nëse universi ndalon.

Shumë prej jush nuk po shijojnë ajkën e jetës, sepse ju keni blerë versionin e mendjes se si gjërat duhet të jenë. Kjo ide të ka shkëputur ty nga Burimi i vetes, kështu që ajo nuk rrjedh më. Rezultatet e disharmonisë dhe vuajtjet. Ti je Vetja, Absolutja, duke u shprehur si spontanitet, por ti nuk e di. Ti as nuk e beson! Ti mendon, 'Çfarë do të ndodhë nëse unë heq dorë nga kontrolli im? Bota ime do të shpërbëhet!' Kështu që ti qëndron në injorancë ndaj përsosmërisë së Qënies që ti je.

Ekzistenca është kujdesi për trupin. Qëndro si "Unë jam" - sensi intuitiv që askush nuk ta dha; që është dhe ka qënë gjithmonë prezente. Nga "Unë jam" gjithçka po manifestohet. Ajo thjesht vëzhgon mekanizmin e universit i cili lëviz nga kjo forcë jetike, kjo frymë në trupin tënd, fuqia gjallëruese në të gjithë trupat. Është një mister dhe nuk mund të zgjidhet. Pra, mos e provo! Observo.

Kush ti në të vërtetë je nuk është e parashikueshme. Mendja është e parashikueshme në përpjekjet e saj për të kontrolluar spontanen. Duke u frikësuar nga e panjohura, mendja shfaqet njëkohësisht nga e panjohura, e cila ofron hapësirën që mendja të luajë si e panjohura dhe e njohura e dukshme. Kjo lojë nuk është puna jote.

Mos u shqetëso për asgjë. Bëhu si një fëmijë në prehrin e Zotit. Thjesht shijoje. Nuk kërkohet as kontrollimi i mendimeve, as mbajtja e një zyre emigracioni për ndjenjat. Ti mund të relaksohesh. Po. Relaksohu.

Pafundësia duket kaq e pafundme;
me siguri, unë do të humbas në të.

Ti mund të humbasësh vetëm nëse je një formë.
Format shihen në ty– E Paformësishmja.
Nëse ti je vetë e Paformësishmja,
ku saktësisht mund të humbasësh
ti kur ti nuk ke asnjë kufi?

"UNË" PO THIRRET NË KUTINË E DËSHMITARËVE

Bhagavan thotë se "Unë Jam" është Realiteti. Mbajtjen me përpjekje e "Unë Jam", ai e quan "vichara", ose vetë-hetim. Kur kjo bëhet pa mundim ajo është Vetë-realizim. Në kuptimin dhe përvojën time, "Unë Jam" nuk është fenomenale. Ajo nuk ka asnjë shije të vecantë dhe cilësi.

Afëherë pse po i referohesh si 'ajo'? Kush është duke folur për 'të'? Kur ti flet për "Unë Jam", çfarë po observon? Sri Ramana në një kohë tjetër bën dallimin midis "trupit bruto" dhe "trupit delikat". "Unë Jam" është "trupit delikat". Si mund të thuash që "Unë Jam" nuk është fenomenal apo pa cilësi? Si mund ta njohësh "Unë Jam" nëse do të ishte pa cilësi apo jo fenomenal? A po flet nga përvoja jote? Ti po supozon këtu.

Sigurisht, ky është një interpretim i mendjes kur ajo është jashtë "Unë Jam". Kur vëmendja është brënda "Unë Jam", nuk ka një "unë" dhe "Unë Jam".

Edhe kur ka një "unë" brënda "Unë Jam" siç ti e the, vetëdija për atë intuitë "Unë Jam" është ende e pranishme. Ajo nuk ka shkuar askund, apo jo? Ekziston vetëdija për ndjenjën e ekzistencës. "Unë Jam" do të thotë "Unë ekzistoj". Ti nuk po pretendon se ti nuk ekziston tani që ndjenja e një 'unë' është e pranishme, apo jo? Çfarë do të bënte një pretendim i tillë gjithsesi?

"Unë Jam" duhet të jetë atje përpara se të mund të jetë çdo njohje dhe perceptim. Të gjitha njohuritë dhe të gjitha përvojat janë funksionimi që buron dhe shfaqet nga kjo intuitë "Unë Jam".

Pra, çfarë e shijon gjumin e thellë? A është "Unë Jam"?

Jo, nuk është "Unë Jam", sepse ti je pa ndjenja në gjumë të thellë. As trupi dhe as mendja – të cilat ne gabimisht i konsiderojmë si qendra e gravitetit të qënies dhe njohjes – ato nuk ekzistojnë për ty në atë gjëndje. Megjithatë, diçka është në gjëndje të japë njohuri për gjumin e thellë kur vetëdija, trupi dhe mendja rishfaqen. Pra, duhet të jetë një Njohuri shumë, shumë më delikate që mbetet. Gjumi i thellë shijohet në prani të një fuqie që ne i referohemi thjesht si Vetëdije. Vetëdija është konstantja në mungesë dhe

prezencë së të gjitha përvojave dhe ajo është e pranishme edhe tani në gjëndje zgjimi dhe është pëpara "Unë Jam". Është nga vetëdija që "Unë Jam" shikohet.

Pra, kur ti thua "observo observuesin", mënyra se si unë e dëgjoj këtë është se ti po e drejton "Unë Jam" të observojë observuesin e egos.

Jo, harroji këto gjëra! Ajo që ti di është se observimi ndodh. Ti ke një ndjenjë të "Unë jam duke observuar" dhe "Unë jam duke observuar objekte". Pyet se kush ose çfarë është kjo 'Unë' që observon? Askush nuk e bën këtë pyetje.

Mos u bëj mental rreth kësaj. Thjesht lejo që ky tregues të ndodhë nga brënda dhe shiko. Diçka lëviz si rezultat i kësaj pyetjeje. A mundet qëndra e observimit–korja e observimit–të observohet gjithashtu?

Harroje se kush do ta zbatojë këtë udhëzim. Thjesht ndiqe këtë këshillë.

Në përvojën tënde, a je ti ai që është i vetëdijshëm edhe për "Unë Jam"?

Sigurisht! Dhe po kështu edhe ti! Mos më përveco mua. Ne jemi një në këtë. Dhe pyetja ime për ty është, a nuk e sheh se edhe ndjenja më delikate, intuitive e vetes - ne e quajmë thjesht intuita "Unë jam" - vërehet në vetvete? Një herë dikush më pyeti: "Mooji, a je ti gjithmonë në kontakt me intuitën tënde?" Unë thash jo! "Kush është ai që dëshiron të jetë në kontakt me intuitën?". Këtu është vetëm intuita. Dhe kush po e bën këtë? Askush nuk e bën këtë.

Ky është gabimi: ti përjeton një "unë" dhe merr atë si "Unë Jam". Ti mendon se është përgjegjësi e ndjenjës "unë" të bëjë diçka për t'u bashkuar me ndjenjën "Unë Jam" dhe të qëndrojë atje sapo ajo të arrihet. Ky 'unë', ky 'unë' është gjithmonë duke ndryshuar formë. Askush nuk mund ta kap atë. Sapo ti e kërkon atë, ai rrëshqet nën tapet. Ti shikon dhe ai është zhdukur, nuk mund ta gjesh. Pse? Zbuloje pse!

Vetëm një që është fiksuar në këtë pyetje dhe qëndron në heshtje do të arrijë në njëfarë sigurie për këtë ndjenjë "unë". Ajo që është kuptimi i kryerjes së "unë", "unë" që lëviz, "unë" që kryen punën, "unë" që shfaqet si një kërkues që përpiqet të arrijë diku; a e ka kapur ndokush këtë "unë" përveç mendimit, kujtesës, besimit? A është gjetur ai? Ky 'unë' ka bërë gjithë zhurmën në botë.

Tani ai vetë po thirret në rutinë e dëshmitarëve. Ne kërkojmë: Prezantoje veten! Si do të shfaqej ai? Ky është introspeksion. Ky është një hetim. Fuqia është me ty për të zbuluar.

Gjithçka që është e perceptueshme, gjithçka që njihet, duhet të shfaqet para teje. Ti je ajo që komenton për të, ndaj duhet të jesh më herët se ajo. Në mënyrë që vëzhgimi të ndodhë duhet të ketë një distancë. Kjo është ajo që do të thotë 'observim'. 'Observim' nënkupton që duhet të jenë të paktën dy: Observuesi dhe i observuari së bashku me funksionimin e observimit. Kush është ky 'unë', observuesi? Kush do ta pranojë këtë pyetje? Lejoi pak hapësirë këtij ekzaminimi! Nëse ky lloj hetimi po bëhet i gjallë në ty, atëherë ti tashmë je në Hir, Hiri tashmë është këtu me ty. Nuk do të të duhen më shumë pyetje tani. Mund t'i numëroj, maksimumi dy ose tre mbeten për t'u pyetur nëse ti ke arritur në këtë pikë për të kërkuar.

Distanca e dukshme
midis vetes dhe Dashurisë,
është vetëm distanca e një mendimi.

Por ky mendim i besuar,
sjell vuajtje në botë.

HIDHI NJË SY OBSERVUESIT

Qëndro si Vetja! Qëndro me zakonin e identifikimit me Vetën sa më shumë që të mundesh. Gradualisht, vëllimi dhe intensiteti i aktivitetit të mendimit do të bjerë dhe vetëm Vetja do të mbetet.

Nuk ka ndonjë tjetër rrugë përveçse kësaj që ti sugjeron? Unë e gjej identifikimin e vazhdueshëm me Vetën të lodhshëm, në mos të pamundur.

Është e lodhshme sepse ti po përpiqesh shumë me mendje. Një tjetër mënyrë është të injorosh çdo mendim sapo ai shfaqet. Për shkak se ti je mësuar t'u kushtosh vëmendje mendimeve, ka të ngjarë që herët a vonë të përfshihesh përsëri me to. Edhe pse e ngjashme në efekt, ti mund ta gjesh këshillën për të qëndruar si Vete më të lehtë sesa të injorosh mendimet, pasi ky është një fokus pasiv dhe jo aktiv. Teksa zakoni forcohet për të qëndruar si Vete, injorimi i mendimeve do të bëhet më i lehtë.

Këshilla jote është të observosh observuesin, por sa herë që unë përpiqem ta bëj këtë, unë bëhem shumë mental dhe shpejt mbetem me një dhimbje koke. Ku po gabohem?

Në fillim, shumica e njerëzve mendojnë se të observosh mendjen do të thotë thjesht t'i kushtosh vëmendje aktiviteteve të ndryshme që shfaqen në mendje. Kjo është mënyra se si mund të interpretohet. Por këshilla është që të qëndrosh shkëputur nga gjëndja e observimit pa u përfshirë me lëvizjet e mendjes.

Mos shiko vetëm aktivitetin; në vënd të kësaj observo reagimin e brëndshëm ndaj aktivitetit. Kjo është më intime sesa thjesht të shikosh lojën e mendjes. Këto reagime tregojnë se sa është kultivuar përfshirja personale; se ku ende ka identifikim dhe 'zhurmë'. Kur unë them "zhurmë" po flas për turbulencën e brëndshme - rezistencë dhe eksitim - që të prish qetësinë. Sapo këto tendenca të njhen, hapi tjetër është të pyesim kush, çfarë dhe ku është ai që identifikohet? A mund t'i vihet një fytyrë atij? A ka një entitet aktual, të prekshëm në vëndbanim si "Unë"? Zbuloje! Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, vëmendja duhet të jetë introverte - e fiksuar në burimin e aktivitetit që shfaqet.

Atje nuk ka asgjë. Kur kërkohet, asgjë nuk gjëndet në një pozicion të tillë.

Mirë. Çfarë po e bën këtë zbulim?

Mëndja ime. Vetëdija ime.

Jo, ti je duke spekuluar. Zemra jote nuk është e pranishme në këtë përgjigje.

Këtu është se ku unë ngec.

Kjo nuk është e vërtetë. 'Të ngecësh' ose një bllokim i dukshëm është vetëm një tjetër mendim. Mos e prano këtë mendim kaq lehtë. Për momentin, mos u identifikoj me asnjë mendim; qëndro e ndarë – e pashoqëruar. Pastaj zbuloj se si çfarë ti po qëndron veçuar? Shiko në këtë me vëmendje të plotë dhe një zemër të hapur. Ndieje rrugën tënde.

Por edhe kjo observohet, apo jo?

Ti lëviz shumë shpejt dhe nxiton në përfundime. Kur vëmendja është e fiksuar në Burimin e saj, ndarja nuk mund të mbetet dhe çdo ndjenjë ndarjeje shkrihet në Burim.

Po them se edhe ky bashkim shikohet, apo jo?

Si mund të jetë, nëse observuesi bashkohet? Ajo që mbetet është vetëm fusha e unifikuar e Qënies. Nuk ka mbetur asnjë pyetje apo pyetës. Shqetësimi që shfaqet nga dhimbja dhe zhurma e ndarjes pushon.

Do të doja të sqaroj vetëm këtë pikë; a mundet që edhe observuesi të observohet?

Ka një aromë mendore nga pyetja jote. Me këtë qasje, asgjë nuk do të vijë nga ky kërkim i yti. Ti thjesht do të mbetesh rrethuar me pyetje. 'Zgjimi' i këtij lloji është dredhia e mendjes për të shmangur zhytjen në zbulimin e vërtetë që është përtej aftësisë së mendjes për të kuptuar.

Jam thellësisht i etur për të gjetur paqe të qëndrueshme dhe kënaqësi të brëndshme.

Atëherë, a je mjaft i qartë në pikat e tjera të diskutuara deri më tani që ti je gati të kalosh në një të re? Nëse je vërtet i etur, një përgjigje e thjeshtë mendore për pyetjen: 'A mund të observohet observuesi?' nuk do të të kënaqë. Përgjigjen e vërtetë duhet ta gësh vetë, duke pyetur me gjithë zemër në identitetin e asaj që shfaqet si "unë" brënda teje. E ndjekur siç duhet, kjo

pyetje nuk prodhon thjesht një përgjigje konceptuale; ajo e gllabëron pyetësin dhe vetëm qetësia dhe paqja e Vetes mbetet.

E PAPERKSHME

Gjendja natyrore e mëndjes është të qënurit në heshtje, bosh, hapur. Ekziston pa qëllim! Nëse mendon se duhet të praktikosh heshtjen, të gjesh heshtje, të mbash heshtje, atëherë e ke keqkuptuar të gjithën këtë. E gjithë kjo, i gjithë universi, është duke ndodhur në Heshtje!

Nuk ka të bëjë me vrapimin për të gjetur pak heshtje. Është të njohësh Heshtjen që nuk mund të shqetësohet kudo që ti ta gjesh veten, pavarësisht nga rrethanat, sado madhështore qoftë zhurma. Reagimet e çfarëdolloj natyre nuk ekzistojnë. Nuk është një sjellje apo një detyrim - ti dhe Heshtja je njësoj.

E gjithë kjo bisedë, ky tregues, është vetëm për të zbuluar Heshtjen tënde. Dhe kjo nuk kërkon kohë! Kur ti qëndron përpara pasqyrës, ajo nuk thotë: "Shiko, unë jam e zënë tani, kthehu pas gjysmë ore!" Kaq e fuqishme është pasqyra e kërimit, sa që ti shihesh menjëherë! Dhe atëherë ti e njeh drejtëpërdrejtë të papërshkrueshmen, të paformësishmen. Ndoshta ti nuk mund të flasësh për këtë, por vuajtja jote ka marrë fund. Frika jote ka marrë fund. Ti pushton vetë vdekjen!

Pra, shumë prej jush, në rastin më të afërt të zbulimit, justifikohen dhe ikin, me frikën të djegin dhe lidhjen e fundit me 'unë'. Mundësia është ta përballosh atë, ta ndjesh dhe të shohësh se ti je e Paprekshmja.

Të ndihesh ngecur është
thjesht një mendim i besuar.
Hiq besimin, dhe ngecja zhduket.

Nëse një dhomë është mbajtur
në errësirë për një mijë vjet,
kur dritarja hapet—
a duhen një mijë vjet
për errësirën të largohet?

Po kështu, në një çast,
drita e së Vërtetës
dëbon errësirën e injorancës.

AMNEZIA NË QËNIE

Unë po vi me shumë rezistencë. Ekziston një frikë madhështore sikur unë do të humbas veten. Unë dua që me të vërtetë të jem në shteg, por më pas nuk e ndjek.

Ti duhet të vendosësh se kush ti je. Identifikimi i gabuar është ajo që të mban ty në një ves. Nëse je Vetja, këtu nuk do të ketë më frikë. Nëse je mëndja egoike, atëherë këtu ekziston frika gjithëpërfshirëse se gjithçka që ti "je" do të zhytet në zbrazëti.

Këtu është frika se jeta nuk do të jetë aq argëtuese nëse unë hesht.

Kur jeta është kaq magjepsëse dhe argëtuese, ti nuk do të kesh tërheqjen për satsang, kështu që nuk të besoj plotësisht. Diçka po shikon edhe në brëndësi gjithashtu.

Po, është.

Dhe kur shikon në brëndësi, çfarë ndodh?

Epo, ka paqe dhe gëzim.

Këto janë thjesht gjëra të vogla... dhe çfarë tjetër?

Pastaj është sikur unë godita një mur.

Një mur? Këtu nuk mund të ketë një mur. Kur perceptohet përmes mëndjes, mund të duket se ka një mur dhe se ti duhet ta rrëzosh këtë mur për të shkuar përtej, por këto janë thjesht ide, sepse është e pamundur që Vetja të jetë larg teje, përveçse si projeksion.

Ti je Vetja në të cilën ideja për të ardhur drejt Vetes po shfaqet.

Por kush do ta pranojë këtë deklaratë? Sepse me sa duket provat tregojnë: se ti po hyn në shpërbërje. Arunachala është një nga vëndet e pakta ku po inkurajohet vënia në dyshim e këtij supozimi! Po, shpërbërja po ndodh, por jo e Vetes. Ti po identifikohesh me përvojën e egos dhe kjo është arsyeja pse ky mur duket real për ty. Ky mur është vetë egoja. Në përgjigje të frikës së humbjes së autonomisë dhe humbjes së kënaqësisë, ajo po përpiqet të mbrojë ekzistencën e saj me idenë se të gjithë Budat janë të mërzitshëm!

Po, ata thjesht ulen në shpella. [Qesh]

Atëherë, pse të shqetësohesh për të ardhur në satsang? [Qesh]

Nuk e di. Unë thjesht vazhdoj të kthehem.

Po, ti vazhdon të kthehesh sepse diçka në brëndësinë tënde e di se nuk ka asgjë të vërtetë për të gjetur në botën e jashtme. Dhe kur je këtu ka gëzim, ka paqe. Askush nuk shqetësohet nga gëzimi apo paqja. Ajo që ty të shqetëson është ndjenja se ndërsa ti je në gëzim dhe paqe ty po të mungon festa diku tjetër, apo jo?

Po

Dhe ky është shqetësim. Harroje shkuarjen tek Vetja ose largimin nga Vetja. Ti je Vetja! Hiq dorë nga këto ide: "Nëse shkoj drejt paqes, atëherë humbas shumë", dhe "Nëse shkoj drejt botës ka kaq shumë kënaqësi, aq shumë gëzim". Sido që të kthehet mëndja apo trupi yt, është e mundur të qëndrosh si Vetja. Ti je dëshmues i tërheqjes ndaj kënaqësisë së kësaj bote dhe i kërkimit të qetësisë. Ky Dëshmues ti je tani dhe gjithmonë ke qënë. Për sa kohë që ti nuk e ke të qartë këtë, do të të duket sikur zgjedhja jote do të rezultojë në një pasojë, e cila do të jetë ose e mirë ose e keqe. Dhe pastaj ka ankth, 'A të marr pilulën blu apo pilulën e kuqe?'

Ti nuk duhet të marrësh asnjë pilulë. Thjesht prano, 'Unë jam këtu si Ekzistencë.' Mos i bashkëngjit asnjë ide Ekzistencës. Mos i jep asnjë imazh. Qëndro në këtë Prezencë pa një imazh, të pashoqëruar. A tingëllon kjo kaq e dhimbshme?

Duket mirë.

Qëndro siç je. Nga lindi kjo ide për të shkuar këtu apo për të shkuar atje? Nga mëndja. Ti nuk ke nevojë të shkosh askund. Qëndro.

Duke e njohur këtë, një qetësi e madhe është e pranishme. Ti nuk do të gësh ndonjë ndarje midis asaj që ti je dhe Heshtjes dhe Paqes; nuk ka kufi në asnjë mënyrë. Kjo nuk do të ketë as kuptimin se 'unë duhet të qëndroj këtu' ose 'duhet ta mbaj këtë'. Njohja do të jetë, Kjo është. Vetëm kjo është e qëndrueshme në vetvete - do të thotë, kjo nuk kërkon ndonjë mbështetje tjetër.

Vetja që ti je, është tashmë këtu, por duhet të ndodhë njohja e kësaj Hapësire të pandryshueshme, e kësaj Vetëdije të pandryshueshme. Për këtë arsye, të kërkoj të njohësh atë që nuk mund të largohet, që nuk mund të vijë dhe nuk mund të shkojë, por që në brëndësinë e saj po zhvillohet loja e ardhjeve dhe shkuarjeve, e shikuar në praninë e Saj.

Kjo që po ndahet këtu nuk është një mësim, është vetëm një kujtesë, një mundësi për të njohur atë që tashmë është kështu. Unë nuk jam këtu për të të shtyrë ty të zhvillosh, krijosh, imagjinosh, por të drejtoj përsëri në atë që është përjetësisht e vërtetë. Vetëm ajo që ndoshta e vetme e meriton titullin: Konstante.

Ajo është e pandryshueshme, por nëse bën përpjekje për të mos ndryshuar, nuk mund ta arrish atë. Askush nuk mund ta arrijë atë. Buda nuk e arriti atë, Jezu Krishti nuk e arriti atë, Krishna nuk e arriti atë. Ti nuk mund të arrish "të qënit në qetësi". Ajo është qetësi e paarritshme. Është e natyrshme; nuk fitohet në asnjë mënyrë. Momentalisht, kjo nuk është e qartë për ty, sepse ka një magjepsje për lëvizjen - lëvizja e identitetit, lëvizja e kryerjes - e cila në njëfarë mënyre duket se eklipson këtë njohje natyrore të asaj që tashmë është këtu.

Dhe jo lëvizja nga vetvetja, por besimi dhe magjepsja për këtë lëvizje shkakton verbëri. Ajo fut amnezi në Qënie. Ti je Qënia. Kjo nuk është kompliment që po të bëj. Çështja është: Ti je perfekt! Por për sa kohë që vëmëndja jote është e rrënjosur në mëndje, kjo bindje nuk do të jetë e plotë. Gjithmonë do të ketë disa dyshime. Ndoshta ti do të kesh një vështrim, një dridhje, por ajo nuk do të stabilizohet, sepse ti je duke u mbajtur pas koncepteve se kush ti mendon dhe beson se je në mëndje.

Ndjenja ime është, kthehu i lirë në hapësirën tënde. Çfarëdo që ke mbajtur këtu me vete, lëri. Zjarri i shenjtë i Arunachulas është një hapësirë e mirë për ti djegur ato. Shko në shtëpi bosh. Kjo do të jetë dhurata më e madhe për kombin tënd, familjen tënde dhe miqtë e tu. Mbaje pasaportën tënde, por ti, ji bosh.

Ti po imagjinon se ajo që ti ke studiuar
dhe se ajo që është në brëndësi të kokës
tënde është ajo që ti di.

Por kjo është vetëm ajo që ti mendon.
Vetëm cfarë është konfirmuar në brëndësi
të zemrës tënde është Njohuria e vërtetë,
dhe njohja dhe përvoja më e lartë është:
'Une jam asgjë'.

VDEKUR NË MBËRRITJE

Mund ta pranoj se jeta është vazhdimisht duke më mbështetur. Mund të filloj të pranoj se tashmë jam perfekt dhe se gjërat do të vijnë e do të ikin, por këtu ka ende një ndjenjë në mua që unë mund të parandaloj gabimet dhe dhimbjet.

Po, kjo ndjenjë e fundit ishte e dukshme që në deklaratën e parë që ti bëre, se ti beson se jeta po po të mbështet. Përgjigja ime e menjëhershme është, jo, ti je Jeta! Nuk ka një 'jetë' dhe një 'ti'. Kjo deklaratë, "Jeta po kujdeset për mua" më ngjall menjëherë këtë përgjigje: Ti kush?

Sapo të largosh vëmendjen nga Vetja drejt sferës së përvojës dhe ta konsiderosh atë si realitetin e vetëm, përfundon duke u ndjerë i divorcuar nga jeta. Ndarja hyn në vetëdijen tënde. Pastaj dikush të hedh një litar shpëtimi duke të të futur me këtë pyetje: "Kush jam unë?" Nëse e refuzon atë dhe në vënd të kësaj përpiqesh të kënaqesh vetëm me mirëkuptim mendor, do të jesh i vdekur në mbërritje.

Është e rrënjosur thellë në psikikën e njerëzimit se ne jemi të ndarë nga jeta; se ja, aty jemi edhe ne edhe jeta.

"Unë kam një jetë të mirë, a e ke dhe ti një të tilë?"

"I gjori ai, ai ka një jetë të keqe."

Por a është e vërtetë kjo?

A është këtu dikush që mund të 'ketë një jetë'?

Ti je Jeta!

Nëse nuk mund ta pranosh plotësisht këtë, është në rregull. Mos e detyro pranimin, thjesht lejoj këtij mesazhi hapësirë të mjaftueshme në brendësi për t'u dëgjuar, mundësinë për t'u marrë parasysh - se "Unë jam Jeta". Nuk ka asnjë hendek midis shpalosjes së jetës dhe asaj që ti je.

Nuk ka asgjë tjetër përveç teje për të thënë se kjo është "jeta ime". Nuk ka asgjë 'tjetër' për të raportuar.

Mëndja përpiqet të të bindë se kjo nuk është kështu. Duke funksionuar si një gazetar i brëndshëm, mëndja vazhdimisht përpiqet të arrijë atë që po shpaloset. Por çdo raport që mëndja shkruan do të jetë gjithmonë një e kaluar, dhe për rrjedhojë vetëm një imazh i së vërtetës, asnjëherë vetë e Vërteta. Edhe nëse lëvizja është një fraksion i një nanosekonde, ti në të cilën lëvizja e raportuar ka ndodhur tashmë je më e shpejtë, përtej shpejtësisë. Për shkak se ti e përmban ndodhinë, ajo mund të ndodhë vetëm në Ty.

Mëndja aktualisht po përpiqet ta fshehë këtë të Vërtetë, ajo bëhet e shqetësuar sepse kondicionimi lind ende brënda trupit dhe ajo nuk mund të shmanget. Vetëdija po vepron gjithashtu në këtë kushtëzim ndërsa zgjohet në pozicionin e duhur brënda gjithë lojës së saj.

Kushtëzimi bëhet në atë zonë ku kushtëzimi mund të bëhet. Por ka një hapësirë ku kushtëzimi nuk mund të bëhet; nga e cila vërehet prania e kushtëzimit, efekti i kushtëzimit dhe loja e kushtëzimit. Ti je ai Shikues. Ti je Shikuesi pasiv. Ti nuk je pjesa aktive. Se kush ti në të vërtetë je nuk është e interesuar në kushtëzim. Në fakt, në fund të fundit, ti as që njeh diçka të quajtur kushtëzim!

Kush e njih atë gëzim që lind kur pyetja
“Kush jam unë?” është bërë dhe asgjë
nuk është gjëndur?

SHTATZËNË ME VETEN TËNDE

Deri kur kam qënë në këtë udhëtim shpirtëror gjithcka vazhdon të bjerë. Nuk kam asnjë interes më për as edhe një gjë, ndihem sikur jam bërë shumë dembel. Nuk mundem të mbaj asnjë takim, nuk mund të angazhohem për asgjë ose të bëj asgjë. Mendimet për të ardhmen vijnë të tilla si; si do ta mbaj veten pa shkuar pas ndonjë pune?

Nuk jam i sigurt nëse kjo që po shpaloset këtu është e vërtetë apo një tjetër lojë shmangieje e mendjes.

Ti je një rast i rrallë. Ti je shtatzënë me Vetën tënde. Ti je duke lindur në një farë mënyre Vetën. Vjen një moment kur të gjitha intereset rrëzohen. Disa njerëz i zë paniku kur kjo ndodh. Ata kanë frikë të shihen si të jo interesuar. Por disi ti nuk e paske problem. Në këtë fazë të vetë-zbulimit, disa mendime të llojit që ti përmende tashmë mund të shpërthejnë nga thellësitë e mendjes për të të frikësuar. Ato do të përpiqen të të hedhin një rrjet dyshimi mbi evolucionin tënd shpirtëror.

Është shumë afër meje ajo që ti po ndan. Ka qënë përvoja ime poashtu që gjërat thjesht po iknin. Dikur kam qënë mësues në kolegjin lokal në mes të Londrës. Kur puthja nga brënda më zgjoi këtë zbulim të Vetes, Zemra më udhëzoi të lija punën. Udhëtimi im më ka mësuar se duke u zhveshur në Qënie e pastër, mund të shfaqen tek ty disa përvoja që nuk do t'i kishe menduar kurrë se kishin të bënin me ty, por ndihet kaq e zhurmshme në momentin që ajo e gjitha rrjedh.

Në rastin tim, edhe pse nuk kishte pasur asnjëherë interes për para dhe kjo është e vërtetë edhe sot e kësaj dite, gjithçka po më linte në atë pikë sa nuk kisha asgjë fare për një kohë. Qindarka ime e fundit u shpenzua; të tjera nuk po vinin më, e megjithatë e dija në zemër se edhe kjo ishte pjesë e fazës së pastrimit të diçkaje. Përvojat që erdhën ishin pjesë përbërëse e një cikli larjeje për të hequr çdo njollë të mbetur nga Qënia.

Disa njerëz thonë: "Unë nuk kam asgjë", por ata kanë pesëqind paund në bankë - kjo është "asgjëja" e tyre - por dua të them se unë vërtet nuk kisha

asgjë! Po shikoja përreth në xhepa; Shkova nëpër rrobat e mia të vjetra për të parë nëse mund të gjeja ndonjë qindarkë apo ndonjë gjë në përgjithësi! Nuk kisha ushqim dhe barku filloi të murmuriste dhe unë do t'i drejtohesha Zotit: "Është koha. Është koha. Ku je?"

Ndonjëherë do të lindnin dyshime për të sfiduar këtë besim të pamasë të Zoti, të cilin unë e konsideroj si sinonim të Ekzistencës; ato dyshime do të sugjeronin se Zoti më kishte braktisur. Por ajo që i tejkalonte këto dyshime ishte një ndjenjë se diçka po zbulonte se "Unë (Zoti ose Ekzistenca) po kujdesem për ty".

Mbaj mend se vëllai im erdhi për të më vizituar një ditë. Ai u ul, nxori një sasi parash dhe filloi të numëronte. Këtu ai ishte duke numëruar një tufë parash përpara meje kur unë nuk kisha asnjë. Një mendim u shfaq atëherë: 'Sikur të kisha një paund, do të isha mirë.' Por në brëndësi e dija se nuk do të pyesja. Është mendja që e dëshiron atë. Është mendja që ka frikë se nuk ka para dhe gjen lloj-lloj justifikimesh pse është mirë të pyesësh. I kisha dhënë para në të kaluarën dhe tani do të ishte momenti i përsosur që favori të kthehej. Por diçka madje u ndjeh e turpëruar nga konsiderata për të kërkuar diçka dhe më udhëhoqi të përmbahesha. Pas kësaj thirrjeje më të lartë, mendja vazhdoi të argumentonte: "Por kjo është një shenjë nga Zoti". Ai po të thotë të pyesësh vëllanë tënd! E shikon sa para ka ai? Kjo është mundësia jote. Merre!"

Por unë po të them, kjo nuk është ajo. Ajo nuk shfaqet kështu. Është sikur ti duhet të jesh shumë në qetësi që të mund të dëgjosh për të dalluar zërin e Zotit nga zhurma e mendjes. Është kaq intime, kjo dashuri e paparë në ty, e cila tani po zbulon të gjitha truket me të cilat ti je mësuar dhe identifikuar. Ti mund të shohësh se sa i aftë je bërë. Sa operator i qetë ke qënë. Të gjitha truket e vogla, të gjitha strategjitë, gjithë forca që ishte maskuar si spontanitet tani po zbulohet për atë që ato janë në të vërtetë. Po, edhe ajo që ti e quaje spontane ishte ende e detyruar, në fakt.

Gjithçka është e hapur ndaj dritës. Ti mund të shohësh se "diçka" ka frikë të arrijë fundin. Nëse frika fillestare që vjen nuk lejohet të të tundojë të ndjekësh këshillën e mendjes së njohur, një ndjenjë e pamasë Hapësire dhe Lirie do të të zbulohet. Nuk është ajo që pret.

Dikush si ty është kaq i bekuar. Të gjitha teknikat dhe strategjitë e tua të vogla për të ekzistuar, e gjithë 'urtësia jote e rrugës', janë krehur. Tani ti je përsëri si një foshnjë e ulur në prehrin e Zotit. Lëre gjithçka të shkojë. Rumi tha diçka të bukur për këtë:

"Kush më solli këtu, duhet të më marrë në shtëpi".

Në secilin prej nesh zhvillohet një udhëtim unik zbulimi. Mëndja ka frikë të shijojë shqetësimin dhe do të përpiqet të vendosë pengesa në rrugë. Do të përpiqet të të mashtrojë me zgjuarsinë e saj. Do të vendosë përpara teje filozofinë. Por ti vjen në zjarr me duar të mbledhura dhe me një zemër të fortë për të mos hyrë në asnjë marrëveshje fajësie. Ashtu siç nuk shkon në një restorant me menunë tënde, ti merr në jetë kështu: Lër çfarë të vijë, të vijë. Në këtë mënyrë gjithçka që është e pavërtetë lihet pas dhe e Pafundshmja zbulohet në shkëlqimin e saj madhështor.

Jam shumë i lumtur për ty. Unë i di dredhjet dhe kthesat e asaj që duhet të ndodhë kur Qënia po nxjerr të gjitha gënjeshttrat. Pra, është shumë, shumë e mrekullueshme. Kur mbështetja në aftësitë e tua të ka lënë pa lëvizje, në këtë moment gjithçka bëhet e mundur. Kur e gjithë mbështetja të largohet nga ty, do të marrësh surpriza të mëdha. Mos mendo se ti e di rrugën drejt çlirimit tënd.

Kur Jeta është mjaft e sjellshme për të marrë gjithçka nga ty, bollëku në çdo mënyrë mund të vijë! Vetëm tani ti nuk je më në varësi. Ti ke pushuar së qëni lypës. Edhe bollëku nuk do të thotë asgjë për ty. E tillë është rruga e të Lirit.

Mos imito Ramanën,
por ndiq fjalët e tij
me besim dhe përkushtim
derisa të gjesh veten në Shtëpi.

Ec sipas dritës së Zembrës tënde.
Rrjedha e çdo lumi është unike.
Unë jam përtej lumit dhe rrjedhës.
Unë jam Vetëdija e palidhur.

NË GJUMË NDËRSA PLOTËSISHT ZGJUAR

Ndihem sikur po cmëndem. Kur bëj hetimin, këtu mbeten dy. Jam unë – njohësi, dhe jam unë si - unë jam duke njohur.

"Unë Jam" që po dëshmon të gjitha këto gjëra është vetëm një faktor. Tendenca është që identiteti të flasë për historinë e vetvetes. Por tani drita është kthyer në të për herë të parë. Çfarë është ky që ka historinë? A ke ardhur në këtë pikë?

E shoh se unë nuk jam trupi por gjithsesi po identifikohem me të.

Mirë, kushtoji pak vëmendje asaj që identifikohet me trupin. Diçka po identifikohet me trupin dhe që ti e quan atë vete. Identifikimi me trupin lind si një identitet "unë" dhe që thotë: "Unë po e bëj këtë ...". Kjo gjithashtu shihet. Pra, shikimi i kësaj duhet të ndodhë në një nivel më të thellë.

Është ai që ka një histori për jetën: 'Emri im është Xhorxhi. Unë jam i kësaj moshe dhe kësaj kombësie.' Trupi nuk po tregon historinë e Xhorxhit. Por ka diçka atje që mban idenë se 'unë jam trupi'. Kjo është e menduar. Një mendim lind, "Unë jam trupi", dhe ai mendim lind si "Unë". Ky, për ty është identiteti i parë. Është identiteti i trupit dhe ndihet intim.

Më lejo të të them diçka, çfarëdo që "Unë" thotë lind nga Burimi. "Unë" nuk mund të vijë nga askund tjetër përveçse vetë Burimit. Edhe "Unë" i djallit vjen nga i njëjti Burim.

Ajo që lind së pari nga Burimi është ndjenja "Unë jam". Vetë "Unë Jam" quhet parimi hyjnor brënda formës. Të gjitha qëniet e ndjeshme e kanë ndjenjën "Unë Jam". Ajo është e pastër në të gjithë, është sinonim i Vetëdijes. Atëherë fuqia për t'u identifikuar lind nga kjo 'Unë Jam' me instrumentin ose mjetin nëpërmjet së cilit ajo po përjeton dhe shijon ekzistencën. Ky identifikim me trupin lind edhe si 'unë'. Ndryshe nga "Unë" parësor që është i pastër, ky "unë" dytësor që identifikohet me trupin është i ngarkuar me interes dhe kushtëzimin vetjak. Kur ky 'unë' flet: "Më pëlqen, preferoj..., unë, unë, unë,

unë", ai mbart me vete shumë forcë psikologjike dhe rëndesë. Është kjo 'unë' dytësore me të cilën duket se ti identifikohesh. Diçka po identifikohet me këtë "unë" që mban ndjenjën "Unë jam trupi". Kur lidhet fort me ndjenjën "Unë jam trupi", atëherë një lind si personalitet.

Imagjino një lavjerrës që lëkundet. Supozo se lavjerrësi është vëmëndja jote. Në një anë është ndjenja e pastër "Unë Jam" dhe në anën tjetër është ndjenja "Unë jam unë" ose "Unë jam trupi". Kur lavjerrësi lëkundet në skajin "Unë Jam", ka vetëm "Unë Jam". Shija e përjetimit tëmd është e hapësirës dhe qetësisë, ka gëzim dhe kënaqësi të ekzistencës. Kënaqësia është në Qenie, ka relaksim, ka paqe. Ekziston një rrjedhë e natyrshme dhëmbshurie ndaj gjithçkaje që vjen në orbitën tënde. Kur lavjerrësi lëkundet në "Unë jam unë" - në kohë dhe se kush unë jam në identitet – ai është më i zhurmshëm, i mundimshëm, gjykues, i kërcënuar, i lidhur, i frikësuar, duke endërruar. Kur ai lëkundet përsëri në "Unë Jam", e gjithë zhurma është zhdukur dhe përvoja jote është ajo e të perceptuarit ashtu si vetëm përmes syve të tu. Ka gëzim në këtë shikim. Ajo nuk është personale.

Sri Nisargadatta Maharaj e thotë bukur. Ai thotë:

"Unë Jam" është si një derë që lëkundet në një anë në të gjithë manifestimin dhe në anën tjetër nëpër Pafundësi.

Kjo "Unë Jam" është e njëjtë me Vetvdiën. Por edhe Vetëdija vjen e shkon dhe nuk është e qëndrueshme. Kur dera në deklaratën e Maharajt, e cila përfaqëson qënien "Unë Jam", është e pranishme, ajo percepton manifestimin. Ti e njeh këtë si gjëndje zgjimi. Në gjëndjen e zgjuar, Vetëdija është e pranishme dhe ti ke privilegjin të përjetosh potencialin e Vetëdijes për të përjetuar diversitetin. Në gjumë të thellë, Vetëdija është zhdukur. Vetëdija quhet gjithashtu "Unë Jam", kështu që "Unë Jam" është zhdukur. Trupi është zhdukur. Por ti je në gëzim të plotë! Kur je në gjëndjen jo-eksperimentale je në gëzim të plotë! Kjo është gjëndja që Maharaj i referohet me derën që arrin në Pafundësi. Nëse e konsideron atë, ti gabimisht beson se kjo gjëndje jo-eksperimentale është ekskluzive për gjëndjen e gjumit të thellë

dhe zhduket sapo Vetëdija dhe gjëndja e zgjimit rishfaqen së bashku me përvojat. Sri Nisargadatta nuk po thotë se dera duhet të shkojë. Rëndësia e vërejtjes së tij është se kjo Pafundësi njihet me anë të vetë "Unë Jam". Vetëm sepse ti i kushton vëmëndjen e plotë kercimit të përvojave në ekranin e Vetëdijes, duke mos i kushtuar aspak vëmëndje "Unë Jam" e cila po vëzhgon këtë shfaqje, ti nuk e sheh këtë, dhe nga ana tjetër përfundon të ndihesh në mjerim.

Ne jemi të dashuruar me gjëndjen e zgjimit, pa dyshim, por e duam edhe gjëndjen e gjumit të thellë. Në gjumë të thellë ti je plotësisht në dashuri, por jo në kuptimin dualist, ti je në Unitetin e Dashurisë. Të gjitha qëniet duan të jenë në atë gjëndje ku nuk ka as 'unë'. Dhe ti e do atë, gjithashtu!

Siç po thoja më parë, kur gjëndja e zgjuar vjen mbi këtë gjëndje të pastër, ti beson se kjo gjëndje e pastër është zhdukur, por unë po të them, ajo është ende këtu. Këto fjalë që po më dëgjon të flas, burojnë nga kjo gjëndje e pastër. Ndonjëherë kjo gjëndje referohet sikur je në gjumë ndërsa plotësisht zgjuar.

Ky ndryshim është gjithashtu pjesë e Vetes, apo jo?

Gjithçka është pjesë e Vetes. Ndryshueshmëria është gjithashtu pjesë e Vetes. Ti nuk mund ta dallosh Vetën. Ti mund të dallosh vetëm paraqitjet që linden në Vete. Por ti e ke lidhur veten me pamjet që janë kalimtare, kështu që ndihesh në paqëndrueshmëri.

Dashuria që ti ndjen për një qenie të vetme
mund të shtrihet për të përfshirë të gjithë botën
pa e shteruar veten.

SATSANG

ËSHTË PASQYRA E VETVETES

Ti thua se dëshmuesi është i ndarë dhe observon gjithcka që shfaqet në Vetëdije, por mua më duket se si vëzhguesi po ashtu edhe i vëzhguari dalin së bashku, dhe për këtë arsye nuk janë të ndarë.

Kjo shfaqet e tillë, sepse ti po flet për dëshminë fenomenale ose personale. Dëshmuesi që unë po drejtoj drejt është Dëshmuesi i pastër, i cili është jopersonal dhe mbetet i pandikuar nga përvoja, dhe nga ai që përjeton. Dëshmuesi i pastër është përtej mendjes dhe kështu nuk mund të lindë në mendje. Është më tepër anasjelltas. Mëndja lind brënda Dëshmuesit të pastër. Kjo dëshmi personale për të cilën ti flet është vetëm një tjetër aspect i mendjes.

Si mundem unë të vendosem më plotësisht në atë gjëndje të pastër?

Është e pamundur që 'ti' të vendosesh në Të! Që në fillim ti bën gabim duke e identifikuar veten gabimisht si një entitet autonom "unë". Kjo ide "unë" është vetëm një mendim që shfaqet në dhe si mendje. Një mendim nuk mund të bëjë përpjekje për t'u bërë "jo-mendim", gjë kjo që nënkupton pyetja jote.

'Ti' si entitet i pavarur, nuk je gjë tjetër veçse një koncept. Dhe ti po sugjeron se ky koncept mund të bëjë një përpjekje për t'u bërë Absoluti, Realiteti i pamundimshëm. Ti vetëm mund të jesh Ajo. Gjëndja e pastër për të cilën ti flet është vetja jote. Ti je Ajo! Ky mirëkuptim dhe njohje duhet në mënyrë themelore të vendoset në brendësi. Atëherë, ti do ta njohësh të Vërtetën në mënyrë spontane.

Pra, nuk ka as edhe një gjë që 'unë' mund të bëjë apo që duhet të bëjë për të qënë Ajo? Nuk jam i sigurt nëse ndihem plotësisht i pashpresë apo i lehtësuar nga kjo që ti sapo the.

Kush ndihet i lehtësuar apo i pashpresë? Të lutem merr disa momente tani dhe sqaroje këtë për veten tënde. Shiko në brendësi; gjurmo pyetjen se nga ajo vjen. Mos u nxito. Fillo duke qënë vërtet në heshtje dhe shiko përgjigjen

e brëndshme ndaj kësaj pyetjeje. Përsëri, kush ndihet i pashpresë apo i lehtësuar?

Një ndjenjë e fortë shqetësimi është e pranishme diku në brëndësi të gjoksit tim.

Pra, një ndjenjë është e pranishme në brëndësi dhe po interpretohet si një ndjenjë e mungesës së shpresës. Çfarë ndodh nëse ti nuk identifikohesh ose nuk e gjykon ndjenjën, por në vënd të kësaj thjesht të lejosh që ndjenja të jetë aty? Për momentin, ti po e drejton vëmëndjen drejt ndjenjës dhe po i jep rëndësi asaj. Por tani po të kërkoj ta kthesh vëmëndjen tek ajo që është e vetëdijshe për atë ndjenjë. Fike tendencën për të shkuar jashtë drejt përvojës. Qëndron vetëm si vetëdija.

Asgjë nuk po ndodh këtu.

Pikërisht! Asgjë nuk po ndodh. Që të ndodhë, që të përjetosh, është e nevojshme të dalësh në rajonin e aktivitetit trup-mëndje. A ka ndonjë ndjenjë zhgënjimi në përgjigje të këtij konstatimi? A e kupton se ti je duke pritur për atë që do të ndodhë më pas?

Më lexove mëndjen.

Për “të radhës”, kërkohet mëndja. "E radhës" sugjeron që vëmëndja po kërkon të kaluarën, të ardhmen, aktivitetet, ndjenjat, mendimet e kështu me radhë. E gjithë kjo shihet dhe i jepet një realitet me mëndje. Dhe mëndja, si veprimtari e qëllimshme dhe jo e qëllimshme, shihet nga ana tjetër. Mos u identifikoj me të parën; ji Observieso i fundit brënda së cilit e gjithë kjo është duke ndodhur. Ki kujdes që të mos i vësh asnjë imazh edhe këtij Observuesi, pasi edhe ky do të jetë një krijim mendor. Observo pa interpretim dhe imagjinatë, dhe e vetmja gjë që mbetet është vetëm Heshtja, vetëm Hapësira.

Kur unë jam në satsang ...

Ky është gjithashtu një mendim. Në momentin që ky mendim preket, satsang vjen në kohë dhe mbahet peng nga mëndja. Në të vërtetë, satsang është vetëm pasqyra e Vetes. Dhe kur është kur ti nuk je vetja? Nëpërmjet zakonit, vëmëndja jote, me të cilën Vetëdija identifikohet natyrshëm, brendh vazhdimisht rreth blerjes së objekteve dhe rrallëherë qëndron në burimin e saj. Kur vëmëndja shkon drejt objekteve, drejt mendimeve dhe ndjesive, kjo

është pavëmëndje. Kur vëmëndja mbetet në Burim, ajo është vëmëndje e vërtetë. Kjo vëmëndje gradualisht do të shkrihet dhe do të mbetet një me Burimin dhe do të bëhet sinonim i Burimit, i cili është përtej vëmëndjes dhe mungesës së vëmëndjes; Ajo është pa emër dhe pa formë. Qëndro si Ajo!

✓ **A je ti gjithmonë në këtë gjëndje?**

Po, pa mundim dhe natyrshëm unë mbetem i tillë. Por të lutem kupto, nuk ka asnjë entitet që e arrin dhe qëndron në këtë gjëndje natyrore. Ti je tashmë Ajo. Ajo është cfarë ne Jemi. Të kuptuarit e kësaj me mëndje dhe zemër të pastër përbën një shikim intim ose përvojë të drejtpërdrejtë dhe kjo është gjithçka që kërkohet. Pjesa tjetër është iluzion. Me guxim të them sepse ke shumë dyshime.

Dyshimet duhet të jenë gjithashtu iluzion atëherë.

Po, poashtu dhe dyshuesi. [Qesh]

SHIKIMI NGA LIRIA

Kjo Tani që është e pranishme, e cila nuk e njeh as konceptin "Tani" dhe në të cilën koncepti "Tani" shfaqet prej- është më e freskëta! Aq e freskët, sa nuk ka nevojë të thuash 'Tani', ose 'Këtu'. Thjesht, mëndja po dekonstruktohet edhe nga më delikatet.

Observo nga Heshtja! Shiko nga Zbrazëtia! Në menjëhershmerinë e të kuptuarit tënd, ti, si një entitet i ndarë, je zhbërë. Dhe atëherë ti nuk po sheh lirinë, por po shikon nga Liria. Ti je Liria. Fenomenet nuk mund të të zënë në kurth.

Ekziston një "unë" që lind nga mëndja dhe ai ka gjithmonë nevojë për diçka. Ekziston intuita "Unë" që lind nga Zbrazëtia dhe ai është përtej nevojës; thjesht shiko. Dhe pastaj është ajo hapësirë pa "Unë" brenda së cilës perceptohet gjithashtu "unë" që është përtej nevojës.

E gjithë kjo në të njëjtën kohë, si Një.

Koncepti nuk është e Vërteta.
Nuk është e plotë - nuk mjafton.
Kur koncepti gëlltitet brënda Zemrës tënde,
koncepti bëhet Prezencë - bëhet e gjallë.
Ajo bëhet energjia krijuese e Hyjnores
dhe derdh dashamirësi mbi botën.

PYETJA IME E FUNDIT

A mund ti, Perceptuesi, të shihesh? Nëse do të kisha vetëm një pyetje, këtë do të të bëja, dhe do të vazhdoj të ta bëj këtë pyetje. Është një pyetje kaq e fuqishme saqë mund të harrosh gjithçka tjetër që ke dëgjuar ose studiuar ndonjëherë dhe ajo do të të çojë në shtëpi.

Nëse ekzistenca jote është thjesht për të kënaqur parashikimet e tua, për të marrë rehati dhe objekte, për të fituar truket e mbinatyrshme, për të gjetur marrëdhënien 'perfekte' ose për të qënë i suksesshëm në botën materiale, atëherë kjo pyetje nuk është për ty dhe të këshilloj të kërkosh diku tjetër. Por nëse zjarri është brënda teje për të zbuluar Natyrën tënde Buda, Vetëdijen tënde të Krishtit apo Vetëdijen Krishna, Vetën tënde, atëherë nuk mund të largohesh prej saj. Gjithçka përmbahet në këtë pyetje. Gjithçka tjetër është dytësore.

Nuk është nevoja që ti të përpiqesh të ndihesh një me të gjithë, ta përjetosh botën si vetvetja, t'i duash të gjithë. Kjo mund të zbulohet spontanisht, por mos puno për të. Imponimi i një koncepti mendor së "njëshmërisë" në botë në fund të fundit vetëm ushqen ndjenjën e "tjetrit". Ajo mund të kultivojë arrogancë në qejfin e përulësisë së rreme. Për të njohur me të vërtetë Atë që qëndron në themel së të gjithë Krijimit, të duhet vetëm kjo: Zbulo se kush je, pikërisht tani! Pse të humbësh kohë duke e shtyrë këtë shpallje më të çmuar?

A mundesh ti, të jesh ideja që ti ke ndërtuar rreth vetes, a mund të jesh arsimi, gjinia apo kombësia jote? Ajo që ndikohet nga planetet, a mund të jesh ti ajo? Ky zbulim është i disponueshëm në këtë çast. Përsëri pyes, a mundesh ti, Perceptuesi, të shihesh? Edhe me dëgjimin e kësaj pyetjeje, pa ndihmën e mëndjes, ajo po bën punën e saj - një riorganizim i perceptimit po ndodh.

A ka kënaqësi për atë që është i lirë, ti pyet? Sigurisht që ka kënaqësi. Kënaqësia nuk është monopol i mëndjes apo egos. E gjithë qenia jote është sinonim i gëzimit.

Në nivelet më të ulëta të vetëdijes ty të duhet, nevojitet një objekt, një marrëdhënie, një qëllim, një koncept, diçka tjetër përveçse teje për të shijuar, dhe kjo është mirë sepse edhe kjo është një lloj gëzimi, megjithëse e kufizuar dhe kalimtare. Por në hapësirën e saj më të vërtetë dhe më të lartë, Vetja po kënaqet. Ajo gëzon manifestimin e gjithçkaje pa u lidhur me ndonjë objekt apo objektiv. Ky gëzim që nuk ka të bëjë me diçka, është gëzimi i të Lirit. Dhe ajo nuk mund të krahasohet, të përçohet apo të imagjinohet. Ajo vetëm mund të përjetohet.

Në fakt, të gjitha shijet e ndryshme të gëzimit që ti njeh dhe kërkon janë të rrënjosura në një gëzim të vetëm të Qënies së pastër, duke përfshirë gëzimin e tanishëm që ti përjeton për të "bërë". Si mund të jetë çdo gëzim i ndarë kur gëzimi është vetë natyra e Ekzistencës? Dallimi midis gëzimit së të Lirit dhe të kufizuarit është se të Lirët nuk po ndjekin asnjë "gjë" apo ndonjë ndjenjë, dhe edhe shkuarja në ndonjë kuptim të "tjetrit" si "tjetri" njihet nga përvoja si vetvetja. Pra, ku është për të shkuar dhe çfarë ka për të ndjekur? Ky gëzim i qënësishëm i të Lirit nuk kalon kurrë.

Ne kemi mësuar kaq shumë koncepte që nuk janë në shërbim të së Vërtetës që ne jemi. Kjo është e gjitha. Është një keqkuptim i thjeshtë. Kur kjo të shihet, cili do të jetë rezultati i kësaj njohjeje? Heshtje dhe qetësi e pandërprerë. Gëzim i pandërprerë. Një gëzim i tillë që edhe pikëllimi mund të shfaqet në të dhe të mos e eklipsojë atë; ku acarim mund të lindë, zemërim momental, çdo emocion, por jo të zgjatet. Ky gëzim përfshin potencialin dhe shprehjen e pafund të Qënies.

Duke thyer kufizimet e veta të imagjinuara, gëzimi i pandërprerë, tani, këtu, e shpall veten si Ti.

Nuk është e rëndësishme të jesh origjinal;
është e rëndësishme vetëm të jesh i vërtetë.

FRYMA E ABSOLUTIT

Në biblën e krishterë thuhet se: 'Në fillim, Zoti e krijoi njeriun nga balta dhe uji dhe më pas i dha atij jetë, dhe njeriu u bë qenie e gjallë'. Pra, cili është njeriu, trupi apo fryma?

Te dyja. Mjeti i shpirtit u formua nga toka. Kur u përfundua, Qënia Supreme mori frymë në formën inerte dhe forma inerte mori jetë. Filloi të funksiononte si një trup biologjik dhe një entitet mendor - një qenie psiko-somatike - një tërësi. Këtu në Bibël është shprehur bukur. Fryma e Zotit është forca jetësore, e cila shpall veten në ndjenjën "Unë Jam" – Vetëdija - "Unë ekzistoj". Vetëm atëherë mund të shfaqej njohja e qënies. Prandaj, kuptimi "Unë Jam" është Fryma e Absolutit.

Por ti thua se Absoluti është përtej procesit krijues.

Po, megjithëse i gjithë manifestimi buron vetëm prej andej. Së pari, Vetëdija, Qënia fluide, duhet të shfaqet. Ajo ka nevojë për një trup që të shpallë praninë e saj dhe të shprehet. Kur trupi është përgatitur në mënyrë adekuate, nxitësi inteligjent, "Unë Jam"- Vetëdija, së bashku me frymën ose forcën e jetës, lëviz në pozicion dhe potenciali për funksionim harmonik dhe inteligjent vihet në lëvizje. Prandaj, Absoluti, ndonëse nuk shkakton qëllimisht shfaqjen e manifestuar, duhet të tregohet si burimi i shfaqjes së të gjithë manifestimit, megjithëse, Ajo vetë është e pashkaktuar. Vetëdija dhe forca e jetës janë, së bashku, fryma e Zotit. Unë po marr lirinë këtu duke iu referuar Zotit si Absolut.

Nga cili pozicion po flet?

Kuptimi i pastër lind nga intelektu i Absolutes së dukshme. Ajo është fëmija (Vetëdija) i Zotit; Njohuria intuitive e universit që shfaqet në trupin e një qenieje njerëzore.

Në këtë rast a mund të thuash se ti je Zoti?

"Unë Jam" është gjithashtu Zoti. Jo në ndonjë kuptim të veçantë apo vetë-lavdërues, jo personalisht, por meqënëse Zoti është i vetmi, duke e shpallur Vetën nëpërmjet intuitës ose njohjes – "Unë Jam" – brënda trupit të çdo

qënieje të ndjeshme, askush nuk mund të ekzistojë veç Tij. Personi ka qënien e tij në Zot, sepse Zoti është gjithëpërfshirës - Ai është Qënia e vetme e ndjeshme. Në Indi, thënia "jiva është Shiva" gjen një lehtësi pranimit. Këtu, 'jiva' i referohet individit dhe 'Shiva', Qënies Supreme.

Termi Zot sjell shumë konotacione të pakëndshme për mua.

Në vënd të kësaj, mund të përdorësh termin Vetëdije.